


ZGIMI



# SHËTZAT

LE  
PLEIADI

VII, 1963 —

# SHËJZAT

[LE PLEIADI]

E përkohëshme kulturore, shoqërore  
e artistike

Rivista culturale, sociale ed artistica

Vjetri VII - n. 9-10 Shtatuer-Tetuer 1963

Anno VII - n. 9-10 Settembre-Ottobre 1963

**Drejtuer Përgjegjës**  
Direttore Responsabile

**MATILDE MANCINELLI**

**Kryeredaktor - Redattore capo**

**MARTIN CAMAJ**

**Selija e Redaksisë dhe e Administratës:**  
Sede della Redazione e Amministrazione:

**Drejtësa për letra e lajme:**  
Indirizzo per la corrispondenza:

**PIAZZA DELLA BALDUINA, 59**

**Dorshkrimet, dhe në qoftë se s'botohen,**  
nuk kthehen.

I manoscritti, anche se non pubblicati,  
non si restituiscono.

**Pronar - Proprietario**  
**ERNEST KOLIQI**

**Derdhja e pajtimeve - Versamenti:**

Conto Corrente Postale 1/23626

## PËRMBAJTJA

### Summario

**HILUSHI:**

**Fjala qet fjalën** (Una parola tira l'altra).

**KARL GURAKUQI:**

**Në kujtim të paharrueshëm të Prof. Lambertz-it** (In ricordo del Professore Lambertz).

**ERNEST KOLIQI:**

**Nji krue melodije qi u thá** (Una fonte di melodia che si è sterilita).

**FRANZ BABINGER:**

**Pinjollit i fundit i familjes s'Arjanit** (L'ultimo rampollo della famiglia degli Arjaniti).

**GIUSEPPE GRADILONE:**

« **Antologia della lirica albanese** ».

**VASIL D. ALARUPI:**

**Gjakmarrje në Malësi** (Vendetta in Montagna).

**MARTIN CAMAJ:**


**Legjenda** (Leggende).

**ERNESTO KOLIQI:**

**Spirito autoctono e influssi stranieri** nella letteratura albanese.

**Kronikë kulturore** (Cronaca culturale).

**Libra të lexuem** (Libri letti).



## Fjala qet fjalën

nga Hilushi

### Albanologjija dhe kongreset ndërkombtare

Kush ndjek me vemendje zhvillimet e studjimeve albanologjike, kudo qi këto të lavrohen, ase ká rasë t'endet shtet në shtet tue u gjetë pranë ndër kongrese ndërkombtare, kudo qi këto të mblidhen, vën roe menjiherë sa pak të njoftun jemi na Shqiptarët nga bota e jashtme dhe me sa pështjellim mendimesh gjikohen punët t'ona. Për shkak të ngjarjeve të përgjithëshme qi, ndër njëqind vjett e fundit, tronditen Europën dhe mbarë dheun e qi hudhën njerzimin në një vòrbull luf-tash e përlëshjesh intestine prej të cilave nuk mujtem të shmangemi as na e qi na cenuen thellësisht, emni i Shqipnis u përhap gjithëkah dhe mund të thuhet se, si vend i vogël qi ásht, zânin e ká bukur të madh.

Por, ç'farë zâni?

Dashamirët e kombit shqiptar, qofshin të shtëjm në daç nga një ndiesi sympathy së thjeshtë në daç nga arsena të themelueme mbi një vetvetësi ase njënjisim (identité) interesash në fushë ndërkombtare, njoftin e çmojnë në të një veti luftarake të rránjosun në një hov trimnije së natyrëshme e bukurue në shfaqje nga një kalorsí e breshhtë (sau-vage). Mâ të kuptueshmit ndër këta dashamirë njoftin skâjín « besë » dhe vetín t'onë gojdhânore të mikpritjes. Pak e kush edhe ndër alba-nologë të huej mâ të zellshëm kapërcen këto caqe.

Dashakëqijjt (e ká bukur nji numër të madh sijs), qi ushqejnë nji urrejtje të pashueshme për gjakun arbnuer të bashkuem me ata qi bijnë flí (viktima) njohunish të gabueme a të cekta, na pandehin e përshkruejnë si rrebela e hajdutën pa kurrfarë prirjeje qytetnije, pa asnji zotsi bashkëjetese shoqnore, të rrezikshëm për vete dhe për të tjerë kur nuk na zaptón kush i huej. Në kët opinjon me larmëni ngjyrash má të randa a má të lehta ndeshim na Shqiptarët tue u endë nëpër botë. Dikush prej të huejvet na i përplasë troç akuzat për fytyrë, dikush tjetër na i ngulë me shprehje të tërthorta.

Përgjitesisht cilsit e nalta shpirtnore na mohohen d.m.th. çdo shkas menduer kah ideali i nji qytetnije eprore. Edhe ai i huej qi përpiqet m'e zbutë disi në vetvete dhe ndër tjerë mendimin e vrazhët mbi né arrin deri në njohje, për sa i përket shpirtit shqiptar, të disa rrebeve rromantike banditash zëmërbardhë të cilat shfaqen në nji dukje pitorreske sjelljesh e qendrimesh.

### Opinion i shtrëmbënuem

Ndoshta ndokujë do t'u duken këto fjalë t'ona tepër pesimiste. E sigurojmë qi e kanë burimin në nji përvojë t'onën të fitueme drejt per drejt n'udhtrimet e shpeshta qi na tokoi me bá në vjett e fundit. Rrethánat e jetës së zakonshëme të tij, e vëjnë shkruesin e këtyne rradhëve në marrëdhânje të denduna me të huej dhe me qarqe ditunore sidome europjane, por edhe amerikane e lindore. Besojmë se i ndodhë sejcilit prej nesh me ndëgjue, sa paraqitet njeriu si Shqiptar, pyetjen (flas për takime me njerz të shkolluem): «Gjuha e juej ásht slave, ás? Jo?! Atëherë i gjet greqishtes. Jo?! Po prej kah rrjedh në qoftë se nuk ásht as slave as greke?».

Fjala qet fjalën... E prej bisedimit mbi gjuhë kalohet n'atë mbi origjinën e popullit shqiptar. E ndëgjohen fjalë të hatáshme... S'din njeriu a m'u idhnue a me e marrë me gaz.

Me shekuj emni i Shqipnis e i Shqiptarvet u vorros në nji harresë të plotë. Tak-tuk ndonji udhëtar i huej na kushtonte pak rrjeshta në shkrime të veta tue përmbledhë në ta përshtypjet e përcipta qi i prodhonte nji kalim i shpejtë nëpër ndoj qytet t'onë. Sa për male, qi përbájnë tri të tretat e vendit, ishin krejt të panjoftuna. Má mirë njihe-shin disa vise të thella t'Afrikës deri në luftën e parë botnore.

Me nji evarí të pamasë duhet t'i rrethojmë emnat e Leibnitz-it, të Thunmann-it, të Xylander-it qi má të parët tërthoqen kueshtën e dijetarvet botnorë mbi gjuhë shqipe e, rrjedhimisht, mbi komb shqiptar. Këtyne pionjervet t'albanologjis i u përkrahen arbreshët At Pál Maria Parrino (1710-1765), rektor i Seminarit italo-shqiptar të Palermo-s dhe prifti Nicolò Chetta (1742-1803), pasardhës i Parrino-s si rektor n'at Seminar; e pak má vonë Vinçenz Dorsa e tjerë studjuesa.

Mandej dolen në shesh t'albanologjis Hahn e De Rada. Por njiherit nisi edhe lufta kundra emnit shqiptar, në qarqe qi rropateshin, për arsye synimesh egjemonike mbi Balkan, m'e paraqitë emnin e Shqipnis si shprehje së thjeshtë gjeografike dhe popullin qi e banonte nji mishmash popullsish turke, greke, latine. Shtete të fuqishme mbështetshin pohimet e gënjeshërta t'anmiqvet t'onë.

*Shumica e Shqiptarvet, të kapërthyem në tyranin e errtë otomane, s'kishin as mâ të paktën dijeni për polemikat e ashpra qi emni dhe çansimi i çashtjes ethnike të tyne shkaktoshin në rrethe ditunore. De Rada, vigân vetmitar, qindronte burrisht n'ato polemika. Mâ vonë u ndihmue nga një aradhe e vogël por e zgjedhun albanologësh, sidomos germanë, në krye të cilvet spikatte Gustav Meyer.*

### **Përpjekje albanologjike të Shqiptarvet**

*Shqipnija, n'aspektet mâ të randësishme të vetat, mbetet edhe sot pjesë pak e njoftun e Europës. Deri vonë as vetë Shqiptarët nuk njihshin mirë vetveten. Paragjikime trashanike turbullojshin mendimin e Verjorvet ndaj Jugorët dhe anasjelltas. Qytetari shkodran pak njëhte popullsin e rretheve të Shkodrës. Botën e Malsorvet të Veriut Fishta na e zbuloi dhe na e thadroi (grava) me vija epike. Por edhe ajo e Fishtës qe një paraqitje syntetike. Hulumtimet etnologjike të Gjeçovit, të Marin Sirdanit, përshkrimi i zakoneve nga Pater Anton Harapi, dhe Ilo Mitkë Qafëzezit, Lef Nosi etj. qiten në dritë ana të botës shqiptare qi as na vetë nuk njihshim. Linguistat edhe etnologët e huej, edhe ata prej siysh qi studjojshin gjuhën e doket e Shqipnis të nxitun nga një ndiesi miqsore, bijshin shpesh në lajthim nga mosnjohja e hollsive të shqipes dhe nga interpretimi krejt i gabuem i frymës së zakoneve t'ona.*

### **Gjendja e sotme**

*Nonse kushtet e sotme, në të cilat jeton shumica e gjindes gjakut arbnuer, nuk mund të quhen kurrsesi të lume, albanologjija është kah zhvillohet për mrekuilli. Paradoks qi shfaqet herë mbas here në historin e kombit shqiptar, i cili përparimet e veta shpesh i ka bënë në periudha kritike luftash e trazimesh. Sido qi të merret, kjo dukuni (fenomene) e çuditëshme dishmon gjallnin dhe fuqin e vërtyteve latente të kombit.*

*Tashti ndër kongrese e mbledhje shkencore ndërkombtare marrin pjesë edhe Shqiptarët. Agoi dita e bardhë në të cilën pranë albanologve të huej rradhiten në punime shkencore edhe Shqiptarët. Me pregatitje t'epër kulturore, ata rrahin me zotsi në referata e në diskutime çashtjet qi për s'afërmi na përkasin. Njofin anat e shëndoshta dhe të dobta t'atyne çashtjeve, i shoshisin paanësisht por njëherit edhe me at dritë depërtuese ndririimi qi dhuron ndiesija atdhetare. Objektivitet, po, — por jo kundrim i thât i cili shtyhet tepër në teposhte të gjikimit johe-nik (négatif) për m'u dukë këthiellti e ftoftë dijetari. Objektivitet nuk don të thotë mos-pëlqim, dënim. Mundet njeriu të jët i drejtë edhe kur gjikimi lëshohet mbi njerz a sende qi dashunohen me shpirt tue rrjeshtue gjithmonë pranë të mbetave edhe të mirat, pa theksim për-buzës e pa paragjikim kundrështar.*

### **Mos të trëmbemi nga kultura**

*Kultura është dritë. Dikush mund të tutet se tue u ndrriçue këthesat e rrethânat historike të kalesës, tue u vû në kandar të përpikët ngjarje e njerz të djeshëm e të sotshëm, tue u zhdavaritë mjegulla shpesh*

ngjye me një prarim kallp që mbështjell doke e vepra e celebritete, kanë m'u shëmbë pilastrat e shqiptarizmit. Frigë e pavend. Shqiptarizmi nuk themelohet në legjenda të shprazta e në gojdhana prrallore por në një shkamb traditash fisnike të cilave sa më shumë t'u zbulohet vjetërsija aqë më tepër do të shkëlqejnë në një dritë bukurije njerzore. Kur etniciteti i ynë iliro-thrak paraqitet lakuriq para botës, biejnë për dhë pohimet e atyne që na nrehin komb i ngujuem në një egërsi zakonesh prapanike.

T'a duem e t'a përkrahim kulturën, sepse ajo si dritë e së vërtetës që është, përditë e më tepër vjen tue u a rritë vlerën filleve indoeuropja-ne t'origjinës s'onë. Shkenca e njimendët përgënjeshtroon mtimet (pré-tensions) poshtënuese t'anmiqvet t'emnit shqiptar. Ata trumbetojnë në katër kandet e dheut se gjuha e jonë përbâhet nga një mish-mash fjalësh të vjedhuna nga fqinjët. Le të vërtillojnë sa të duen. Sot indoeuropeistat e romanistat shtëjnë në punë me shumë dobi shqipen, si gjuhë të vjetër, për të zgjidhë problemet gjuhsore më të ndërlikueme. Vikasin anmiqt tonë poshtë e përpjetë se populli shqiptar s'është veç se një grumbullim njerzish me zanafille të ndryshme dhe me doke laralara keqas të përzieme; anë: shkenca po vjen tue dishmaue dita ditës njisin kompakte të substratit etnik shqiptar dhe frymën e naltë njerzore të tharmit që lëvitë në normat e lashta të së drejtës kanunore burue origjinalisht nga ai substrat. Botë-kuptimi i gjindes prej gjakut iliro-thrak mbështetet mbi parime të shëndoshta që kanë në palc të tyne nderimin ndaj Hyun, kultin e votrës shtëpijake, ruezjtjen e nderit të vet dhe të t'afërmit, andjen e mikpritjes. Andja e mikpritjes tregon prirjet e mëdhaja shoqnore të Shqiptarit. Shqiptari dishron m'u miqsue me gjithkënd. Nuk nget kënd po s'që i ngucun. Kultura i vërteton këto veti dhe na i zbulon në dhe i a bân të njoftun të huejvet.

E kultura nuk është veç dritë ndriquese, por edhe nxehtësi flakuese që shkrinë çdo brânzë (scorie) a tepricë ndikimesh të dâmshme. Dihet që sa më tepër njëf njeriu, aq më tepër kupton e dashunon. Shkenca, tue e bân me shkëlqye shqiptarizmin, — d.m.th. synthezën a përmbledhjen e vetive më të kullueta arbnore, — në të gjithë madhënin e vet të njimendët i ep një arsye-qënjeje idealeve t'ona kombtare, të cilat synojnë, pa prekë të drejtat e kurrkuj, naltësimin e popullit t'onë në sferat më të larta njerzore e shoqnore ku do të lulzojnë lirisht vetit autoktone për dobi t'onën dhe të mbarë njerzimit.

Ndonji dijekeq, kur na flasim për një fuqisim të vlerave autoktone, për një nderim të mytit të gjuhës e të gjakut në përbashkët, ndoshta mund t'argtohet të na hjedhin akuzën se na rrëshqasim, deshtas a padeshtas me ato shprehje, në qindrime raciste. Qetou, or shok plot skrupuj! Na nuk ushqejmë mendime imperjaliste: lê, që po t'i ushqejshim do t'u bájshim qesharakë me at numër të pakët njerzish të përfshim nën emën të racës shqiptare! Jo racizëm, por synim e përpjekje me qënë më parë Shqiptarë të mirë e vetëdijsa të vlerës s'onë edhe mandej qytetarë të botës.

Kush mohon veten, as tjerret nuk u duhet gjâ.

# Në kujtim të paharrueshëm të Prof. Lambertz-it

(27-7-1882 — 26-8-1963)

nga Karl Gurakuqi

Mbrenda pak kohe, rreth këtij vjeti, u zhdukën nga skena shqiptare tri fytyra të ndrituna, të shqueme për veprimtarí në dobí të Shqipnís, të tre miq e dashamirë, nji i huej e dy bij të dheut arbnuer. Të tre, kush mâ shum e kush mâ pak, në moshë të shtýme, por nuk ásh t moshá masa e idhnimit, ásh t puna e vlefshme, së cilës i u këput fija, janë kujtimet e mira qi na lidhin me ta: *Mehdi Frasheri* (vdiq me 25 máj), fytyrë politike, qi për mâ tepër se nji gjymës shekulli u dallue në jetën t'onë kombtare si burr i matun shteti, i ndershëm, atdhetár i pastër; *Ali Këlcyra* (vdiq me 23 shtatuer), mik i pandám i Luigj Gurakuqit, gojtár i ámbël, përparim-dashës, idealist, i cili u mundue gjithmonë për të vù në hullí partít e ndryshme të mërgimit t'onë.

Ndërmjet këtyne dý datave të zeza, me 26 gusht, mbylli sýt miku i madh i vendit t'onë, prof. Maksimiljan Lambertz-i, qi la nji vend të zbrazët në rrethin tashmá të ngushtuem t'albanologvet, qi mbas luftës së dytë botnore erdhën tue u paksue, pse Shqipnija u a mbylli dyert. Nuk shifen mâ tue bredhë të patrazuem nepër viset t'ona shkencatarë si përpara; miqt na janë rrallue. Vdekja prandej e Lambertz-it ásh t dyfish e dhimbëshme, dyfish e rándë. Ky pat ardhë në vendin t'onë në moshë shum të ré, atëherë kúr Shqipnija gjindej në hapat e parë të përformimit të jetës shtetnore. I u vù menjherë studimit të gjuhës tue pasë si udhëheqës Fretnit e Shkodrës me në krye Fishtën, prej veprave të të cilit nxûni me i hý në shpírt jetës së Shqiptarit. Burimin mâ të mirë për studimet e veta e kërkoi dhe e gjeti në kángët popullore, n'epikën e malevet; qysh prej asaj kohe nuk u lodh kurr të gjurmonte thellë e mâ thellë folklorën shqiptare. E pat fillue veprimtarin në ket drejtim me nji studim të shkoqítun me titullin «*Poezija popullore e Shqiptarvet*», qi e botoi në gjuhën gjermane në fletoren «*Posta e Shqipnís*», drejtue nga Gjergj Fishta, rreth vjetvet 1917-18. Në shtyllat e asaj fletorje shkodrane pat qënë zgjatë n'analizimin e gjinivet të ndryshme të poezís kreshnike, e, mund të thohet, se atij i përket meritimi i parë i njij studimi sistematik i kësaj dege. Deri atëherë poezija e jonë popullore, përveç disá përmbledhjeve të thjeshta, pá kritere e pá metodë, nuk kishte qënë objekt hulumtimesh shkencore. Kësaj i kushtoi krejt energjin e vet, u krrus, u gërmuque mbí tryezën e punës për t'a shqyrtue, për t'i hetue bukurín dhe rándésín.

Në radhën e punimevet në fushën folkloristike shqiptare, është për t'u shenue studimi i tij i hollësishëm i qërthullit, i ciklit të Mujit e të Halilit. Për ket studim u mbështet në tufën e këngvet të mbledhuna e të rendituna nga Bernardin Palaj e nga Donat Kurti («*Visaret e Kombit*» - Vëllimi i dytë «*Këngë Kreshnikësh e Legenda*» - Tiranë, Shtyp. «*Nikaj*» 1937, faqe 286). Titulli i kësaj monografije lamberciane është «*Die Volksepik der Albaner*» dhe u botue si ekstrakt nga revista «*Wissenschaftliche Zeitschrift*» e Universitetit të Leipzig-ut (Vjeti IV, 1954-1955, faqe 47 dy shtyllash, format i madh).

Punë të rrallë kreu Lambertz-i me përkthimin gjermanisht të kryeveprës «*Lahuta e Malcís*» me gjith ato mënyrë shprehjeje popullore, të natyrshme në gjuhën e Fishtës, por të vështira të sillen në një gjuhë tjetër. Përkthimi «*Die Laute des Hochlandes*» (Verlag «*G. Oldenbourg*» München 1958) u ká bá të njoftun rrethevet albanologjike xhevahiret má të shkëlqyeshme të botës s'onë letrare, e cila, ndonsë ndoshta e ngushtë, ndrÿnë cilsí të lakmueshme të njëj gjindjeje, qi ká ruejtë pastër gjuhë e zakone në mes rebeshesh e stuhish, qi s'ká pranue kurr t'u uli kryet të tjervet e të njajzohet me popujt lakmimtarë të kufinit apo me ata qi i a shkelën vendin. Këtij përkthimi i pat prí disá vjetë má përpara në vjetin 1949, në një vëllim të posaçëm, një introdukcjon ndrìgues e veprës fishtjane «*Gjergj Fishta und das albanische Heldenepos "Lahuta e Malcís" - Eine Einfuhrung in die albanische Sagenwelt*» (Otto Harrossowitz - Leipzig). Na shpjen në botën legjendare shqiptare, me lugetën e kulshedra, me floçka e me lubija, me drangoj, me orë e zana, me një fjalë, n'atë jetën burrnoreparake të Shqiptarvet, së cilës tashmá është tue i a zânë vendin një mendësi e ré qi s'ká të bájë me ndiesít e me prirjet natyrore të popullit.

Jo vetëm në fushën folkloristike, por edhe n'atë të gjuhësis Lambertz-i ká bá gjurmime e studime të rëndësishme: monografít e tija mbí djalektet e Shqipnis e të kolonivet arbreshë janë të çmueshme, të cilat i çelën rrugën hulumtimit të mátejme. Materjali i mbledhun në ketë lámë, artikujt e shumtë, konferencat në qendra dijtunore, na japin një idé të kjartë të njohumivet qi i ndiemí ká pasë mbí gjuhën t'onë. Po çekim këtu dy monografít e fundit: në revistën «*Lingua Posnaniensis*» (vëllim VII 1953, faqe 85-144) trajton të folmen popullore të krahinës së Gjinokastrës; shtjellon fjalë të mbledhuna nga goja e popullit, rreshton e përkthen urime, bekime, námë e mallkime, ngushllime e përshëndetje, me të cilat shqipja e çdo krahine është shum e pasun. Monografija e dytë rrokë përkthimin dhe analizimin e veprës së Jul Varibobës «*Gjella e Shën Mërisë Virgjër*». Edhë kjo është një ekstrakt nga revista «*Zeitschrift fur vergleichende Sprachforschung*», vëllimi 74, vjeti 1956. Ká vleftë të madhe sidomos fjalorthi i nxjerrun nga vepra e Varibobës. Fjalorthi është trí pjesësh: 1) elemente shqipe; 2) elemente greke; 3) elemente italjane. Natyrisht kjo pjesa e tretë përfshín shumicën e fjalvet.

Prof. Lambertz-i për disá vjetë me radhë pat dhënë mësimë të gjuhës shqipe n'universitetin e Leipzig-ut. Për lehtësín e studentavet, botoi këto vepra: 1) «*Libër leximi i shqipes*» në dy vëllime (1948),

ku janë të radhituna copa të zgjedhuna, të nxjerruna nga auktorë shqiptarë me përkthimin gjermanisht, ashtu edhe biografi të shkurta të shkrimtarvet; 2) «Kurs i mësimi të gjuhës shqipe» në tri vëllime (1954-1957); 3) «Shqipnija tregon» qi është një antologji e letërsisë së sotme shqipe.

Sikursë na shkruen në një letër pak kohë përpara se të vdiste, ka edhe të tjera monografi, studime mbi probleme gjuhësore e letrare; ka lënë mjaft përkthime auktorësh shqiptarë. Të gjitha këto prishin revizime, qortime e përmirsimet e pastaj botimin. Për këtë e qajmë edhe më fort vdekjen e tij qi e rrembeu tue i lënë punën për gjymës.

Familja e «Shêjzavet» i parashtron së shoqes fisnike e farefisit të tij ngushllimet më të ndieshme.

### « Collana di Shêjzat »

MARTIN CAMAJ: «Djella» - tregim në prozë e në vjerrshë - Romë 1958, faqe 142.

Çmimi: N'Itali	Lit. 800
Ngjeti	\$ 2

MARTIN CAMAJ: «Il Messalé» di Gjon Buzuku - Contributi linguistici allo studio della genesi, Romë 1960, faqe 90.

Çmimi: N'Itali	Lit. 1.500
Ngjeti	\$ 3

HILUSH VILZA: «Shija e bukës së mbrûme», rromanx - Romë, 1960, faqe 173.

Çmimi: N'Itali	Lit. 1.000
Ngjeti	\$ 3

GIUSEPPE GRADILONE: «Studi di Letteratura Albanese» - Romë 1960, faqe 247.

Çmimi: N'Itali	Lit. 1.500
Ngjeti	\$ 3

*I libri della «Collana» si trovano presso le seguenti Librerie:*

P. TOMBOLINI - Via IV Novembre, 146 - ROMA

LIBRERIA EDITRICE SCIENTIFICA RELIGIOSA

Piazza Montecitorio 117-120 - ROMA

CASA DEL LIBRO (Dott. Brenner) - COSENZA

# Nji krue melodije qi u thá

nga Ernest Koliqi

Edhe pse i zymnuem nga ndjekjet e një orës së zezë, në rrjedhje të historis së vet, Shqiptari dijtí t'i mujnë në vete ndiesít trishtuese dhe të lëshohet n'andje ngushllimtare të kángës. Ká et melodije, lakmon defrimin muzikuer. Kánga i a përsolli jetën mbi kët shekull plot me lot prej djepit n'arkivol. E në kángë shfren mallet e mshefta të shpirtit. Pjesën má të mirë të shpirtit të vet e shprehë në kángë. Jonet qi ndryjnë afshet e tija kanë shpesh-herë tingull mjerues, por kumbojnë edhe papritmas me hove hareje. Mjerimet e paprémë ndikojnë pikllueshëm në fjalë të kángëve dhe në motiv muzikuer të tyne, por aty-këtu dridhet edhe një zâ i gjallë shprese, një brohorí lartushtuese qi dishmon besimin e tij të ngulun në një këthesë orëbardhë të fateve.

S'kemi ende një historí të plotë të muzikës shqiptare. Muzika, ndër arte të bukura, ásh t má e vishtira, ajo qi zhvillohet má e vona ndër shoqe. Prej kángës së paëmën popullore për t'arrijtun në melodín artistike, d.m.th. në krijesë të vetëdijeshme të muzicistavet me shkollë, duhet shumë kohë edhe një varg përpjekjesh të denduna.

Unë s'kam një pregatitje të përshtatëshme për të shkruar si duhet mbi art të tingujvet e të zâneve, por tue qënë andaq (*marakli*) i madh kángësh dhe ç'prej rinije ndjekës besnik ahëngesh e koncertesh, po lëjohem këtu me rrjeshtue në mënyrë empirike disa vërejtje e përshtypje mbi muzikë shqiptare.

Mal e fushë, qytet e fshat të Shqipnis vlojnë me shfaqje muzikore në rasa të veçanta në daç nëpër rrotullim të vjetit, si ndër shregulla të Shën Gjergjit, në qethje të deleve e në të vjelun të rrushit, në daç nëpër rrotullim të ciklit të jetës njerzore si ndër gostít për fejesa, ase në celebrime martesash. Ka edhe rasa shfaqjesh tjera, por po kufizohem të përmëndi ato má në shëj. Vallet qi ndëgjohen në këto rasa hýjnë në rendin e kángëve të vjetra. Zbresin prej kohnave má të lashta dhe në thjeshtësín e vet përmbajnë tharmet muzikore má të mystershëme të shpirtit shqiptar. Në tematikën pak notash të tyne mshehet fara autoktone e cila, kur të biejnë e të mbiellet në një shpirt të pajisun me fuqí krijuese ka me bëjtë e lulzue në vepra origjinale.

Përkundrazi n'ahëng ndiehet influksi i Lindjes. Edhe aty nuk mungon origjinaliteti. Kángët e Nezim Frakulles, për shembull, ase të Palok Kurtit duhet t'i çmojmë si xhevahire t'artit t'onë muzikuer, por vërehet në to një përpunim tjetër má i rafínuem, një pasuní ngjyrash qi largohet nga thjeshtësija e njomë e shfrimit melodik populluer. Vjerrsha e muzika e kángëve t'ahëngut janë prodhim refleks ku deshtas auktorët, kush má me shumë kush má me pak zotsí, në tymen të poezís

e të melodis popullore shqiptare përshkojnë indin e motiveve origjinale të frymzimit vetjak.

Këso mendimesh më sielleshin nëpër krye tue shfletue veprën e gmueshme *Valle Kombëtare* të muzicistit shkodran Gjon K. Kujxhija qi në lule të rinis dhe në vlug të fuqive krijuese vdiq tue pasë moshën njizetrvjעהare në bombardimin qi pësoi Firenze me 25 shtatuer 1943. Mbushen pikënisht njizet vjet në këto dit.

Ky djalë, i pajisun me cilsí të rralla morale e mendore, e me një talent të posatshtëm muzikuer, bashkote në vetvete vetina të spikatuna kompozitori me zotsí të ndritëshme muzikologu.

Parathánja qi i vûni në krye pjesës së parë të veprës së vet, *Dasëm shkodrane*, në pak faqe përmbledh synthetikusht idëna e gjikime sa me ushqye shtillin e një vepre bukur të vëllimshme. Aty ai tregon vijën evolutive të muzikës shqiptare, natyrisht tue marrë në studjim zhvillimin e saj në Shkodër. Thotë qi qellimi i tij ishte të mbledhi e të bájë hulumtime mbi muzikën popullore të Gegnis njisherë e mandej të Toskënis, por kohnat e shqeta (lufta e dytë botnore) dhe vishtirsija e udhëttimeve (vullnetit e zellit të fortë i a pritshin hovin mungesa e mjetevet) e shtrënguen të marrí si piknisje má s'pari folklorin muzikuer të Shkodrës, tue lânë për një kohë të dytë analizën e kángve të viseve tjera.

Besoj se ishte vjeti 1942 kur erdhi të më shofi n'Institutin e Studimeve Shqiptare në Tiranë. Edhe sot e kam para sýsh fytyrën e tij të hijeshme përshkue si me një tis të stërhollë melankoliqe. Drita e thellë dh'e qetë e sýve tregonte pasunin e idëve dhe të ndjenjave të mbylluna në shpirt. Shifej se hota e tij e përmbrendëshme vlonte me dishire të ndezuna realizimesh artistike. Unë e njihshem deri n'at ditë për të páam, por n'at takim ndjeva të të rrahunit e qellimeve të larta qi ai ushqente. Muzika, për të, s'ishte vetëm mjet argtimi, por mënyrë për të depërtue në thellësit e substancës ethnike, flatër m'u ngjitë kah sferat e epëra t'idealeve njerzore, flakë pastruese qi fuqison prirjet má bujare të shpirtit.

Thotë në parathánjen e përmendun sipër se familjet shkodrane në zá Parrucejt, Toskejt, Llupejt, Sumejt, Çekejt, Muzhájnt kanë ndihmue e mbajtë me shpenzime të veta muzikanta të zotët për të zhvillue ndër né hovet «e lartësisë shpirtnore».

Mue më báni përshtypje besimi qi ai kishte në fuqin edukuese të muzikës dhe mendimi i prëm se ajo e muzicistit ásht vepër mirërritjeje dhe misjon qytetnues.

Por ajo qi sidomos më pelqej qe ideja e tij se në Shqipni piknisjen e vet muzika reflekse duhej pa tjetër t'a kërkonte e t'a gjënte në jonet popullore. Përmendi rezultatet e arrijtuna në ket drejtim nga At Bernardin Palaj në melodit e në koret e «Shqiptares së Qytetnue-me» dhe nga D. Mikel Koliqi në muzikim të poemeve dramatike të Zadëjës.

Qyshë n'at ndëje të parë më çuditi me mprehtësin e depërtimit në thalb të çashtjeve dhe me këthielltin e gjikimit. E në fytyrë shprehse e në sjellje të njerzishme e të matuna, pasqyrohej bashkë me fisnikin e shpirtit një prirje mos me u dhânë tepër randësi kushteve të jetesës

së përditëshme por m'u mbledhë e m'u përqendruë në lavrim t'artit muzikuer.

Muzika, për të, ishte bâ arsye jete, qellim qënësuer, torturë dhe galdim. A nuk thotë Shelley për muzikën: «...Çels i argjantë i çezmes së lotve ke i çili shpirti pin deri sá mendja mahnitet... Shpirti i im — si një sulë e mrekullueshme — rrëshqet mbi valët e âmbëla të kângës t'ande e shkon larg larg larg në viset e avullueshme t'andrrës.»?



**Muzicisti Gjon K. Kujxhija**

Thotë, gjithënji në parathânje, se mjeshttrat e tij të Konservatorit dhe dy kompozitorë të përmendun italljanë, mbasi i panë e i shqyr-tuen motivet e valleve shkodrane, dhanë një gjikim pozitiv tue pohue se i kishin gjetë shum t'interesantëshme. Një muzicist i madh Zandonai, auktori i veprës «Françeska nga Rimini» (emnin nuk e shënjon në

Fuqin shortare të muzikës ai kështu e ndiente pse në shikimin e tij të butë ndritte prirja kah rrëmbimet ajrore në botën e fantazisë. Por, si e çeka edhe më nalt, muzika s'ishte për të vetëm arratë e âmbel, mjet ikjeje fluturuese nga mër-zit e vogëlsit e jetës së rendomtë kah kaltherimi vezulluer i qiellave t'artit: jo; këtë art ai e njehte vegël pune t'aftë për hapje udhash të reja kah arrijtja e Bukurisë, të një Bukurije ngushllimtare vendosë në majet më të nalta të jetës ku duhej t'arrinte shpirti kolektiv i kombit. Shpirti i tij rrëshqitte mbi valët e fuqishme të kângës së madhe shekullore të popullit. At lum muzikuer ai mendonte m'e këthye n'âmë t'artit refleks për t'a bâ m'u derdhë në dët të Bukurisë u-niversale.

vepër por m'a tha me gojë kur u takuem në Selín e Institutit të Studimeve Shqiptare) i pat premtue se do të vëhej me i studjue imtisht motivet e muzikës rudimentale të valleve për të mujtë me i dhânë popullit shqiptar kontributin e tij me vû bazat e një muzike kombtare.

Këto fjalë dishmojnë se Riccardo Zandonai ishte i bindun qi në motivet e këngëve shumë të vjetra të popullit shqiptar kishte aq substancë artistike sa me ushqye një rilindje muzikore me veti të theksueme ethnike.

Mos të mendohet se Gjoni kishte mendën e ngulun veç në hulumtim e studim të thát të muzikës kombtare. Dijmë gjind qi flasin shumë bukuri e hollë mbi muzikë, por tue e ndëgjue nuk pësojnë tronditjet misterjoze qi ajo u dhuron shpirtënvet të zgjedhun e nuk arrijnë në çmim të plotë të hirit mbinjerzuer të saj. Përkundrazi muzicisti i ynë orzi i a çmonte dhe i a ndiente shortin me ato cilsí qi Schumann thotë se lypen në një shijues të vertetë të muzikës: me vesh të hollë, me mende kuptuese, me zëmër të ndieshme. Biografija e tij na dishmon qartas se art e jetë lidheshin në të në një nye të pazgjdhëshëm.

Gjon Kol Kujxhija lindi në Shkodër me 11 maj 1920. Familja e tij përbáhej prej shumë vëllazënvet e motrave. Prirja muzikore u shfaq në të qyshë në moshën më të njomë. Tregon e áma se një herë tue ndëgjue ujin kah vlonte në gjygyt te votra, ndëi pa luejtë tue e vesh tue me vemëndje të madhe e mandej tha: «Ndëgjoni si këndon gjygyti tri-katër zánesh!» Në shtëpin e Kol Kujxhis, çerdhe e vokët ku shpërthente hareja në këngë si në shumë tjera ambjente familjare shkodrane, Gjoni u bá drejtuesi i korit të përbám nga vëllazënt e motrat e tija. Shpejt grupit të këngatarvet shtëpijakë i u shtuen camerdhokët e vajzuket e lagjes. Gjoni i drejtonte me dallí dhe me ndihmën e vetive muzikore të natyrëshme të linduna me të. Ndoqi me cenë studjimet fillore e gjymnazike. Në gjymnazin «Iliricum» t'Etënvet Franciskanë vazhdoi të mirret me muzikë tue mos lánë m'anesh landët tjera. Aty nën drejtimin dashamirës të muzicistit të shquem At Martin Gjokaj përparoi shpejt e mirë si në përdorim të veglavet muzikore ashtu në teorína të muzikologjis. Bani pjesë në kore e n'orkestra tue u dallue për teknikë egzekutimi dhe interpretim të copave klasike.

Flitte me bindim t'evارشëm për At Bernardin Palaj, frati gjenjal i depërtuem në sekretet më të thella të muzikës e të poezís. Bernardini sigurisht e udhëzoi kah vlefësimi i motiveve popullore dhe i a zgjanoi horizontet artistike me at entuzhazëm të ndritun qi edhe atë vetë e pushtonte si para zánit të dalun nga msheftësit e zëmërës së popullit ashtu para kryeveprave të muzicistave të mëdhej botnorë.

Shkodra ka tradita të shënueshme edhe n'artin muzikuer modern. Kongregacioni i Nuncjatës i Kolegjës Saverjane qyshë prej 1876 kishte çelë një Shkollë Muzike. Me 1878 u ngreh e para bandë qytetare e Shkodrës, pjestarët e së cilës vesheshin me brandavekë, jelek me sumbulla e fes tanuz. Me 1889 funksjonoj e para orkestër gjithënji me nisjativën e kujdesin e Etënve Jezuitë. Rrafshi i shijes muzikore në Shkodër u naltue shpejt sepse gjeti vend ku me prodhue fryt të pëlqyeshëm.

Gjoni bani pjesë edhe n'aradhën e amatorvet të grumbulluem në «Schola Cantorum» themelue e drejtue nga Dom Mikel Koliqi. Endë

mbahen në mend shfaqjet e admirueshme të melodrameve Ndrë Zadëja-Mikel Koliqi, qi kjo shkollë organizoi në Shkodër. Në to pat pjesë kryesore si këngatar e pjestar orkestre edhe Gjoni.

Me 1938 ándrra e tij me dalë përjashta për të krye studjimet muzikore u realizue. U nëshkrue në Conservatorium të Firencës.

Kishte plane guximtare: me mbledhë e komentue folklorin muzikuer shqiptar dhe m'e shfrytzue në krijesa origjinale ku të ndiehej fryma autoktone. Hartoi copa për orkestër e për kor, në të cilat spikatë talenti i tij i pashoq.

Lên të botuem *Vallet Shkodrane* të dasmës dhe të shrrregullavet; të pabotuem dorshkrimin e mbledhjes së vargut të këngëve t'ahëngut. Deka i a këputi veprimtarín shi në kohën kur vetit e tija të rralla ishikah lulzoshin në krijesa të shkëlqyeshme. Rá si landë prendverore qi stuhija e papritun shëmbë me gjith bula të paçeluna qi do të dhurojshin një mrekullí lulësh e pëmësh.

Me ndienjen má të gjallë përmallimi na e përkujtojmë sot Gjon K. Kujxhin si një pjonjer të dalldishëm në lámën e artit muzikuer. At lámë janë tue e livrue tashti tjera talente të reja. Artet e një populli janë vargue i përbâm nga shumë hallka. Në vargun e muzicistave shqiptarë qi u përpoqen edhe përpiqen me shprehë në bukurín e notave edhe të zâneve thesarín muzikuer të mshefun në palët má t'ímta të kombit, Gjon K. Kujxhija shkëlqen si një hallkë ari.

*Të dashun Bashkatdhetarë!*

Po mbushet vjeti i shtatë i së përkohëshmes *Shêjzat*.

Tregonja sympathín t'Uej redaktuesavet të saj, të cilët nuk kursejnë mundin e tyne për të plotsue egzigencat kulturore të të mërguemvet, tue dergue me kohë pajtimin e vjetit 1964.

Mos u vëni vesh atyne qi përhapin fjalë se e përkohëshmjia e jonë ká sigurue daljen e vet dhe nuk ká nevojë për ndihma dashamirësh. Botimi i saj gjën vishtirsína të çdo lloji qi vetëm zelli dashnuer i redaktuesavet kapërcen tue mos pasë asnjí shpërblim landuer. Botuesat gjëjnë kënaqje vetëm në mendim qi janë kah kryejnë një shërbim në dobí të çashtjes kombtare dhe t'Artit.

*Pajtonju në Shêjzat dhe gjëni në rrethín shoqnuer t'Uej pajtimtarë të rij.*

# Pinjolli i fundit i Familjes s'Arjanitasvet [«Das Ende der Arianiten»]

nga Franz Babinger

(vijon nga numri 3-4, vjeti 1963)


Menjiherë mbas emnimit të Konstantin Arianitasit si qeveritar i qytetit dhe i kështjellit të Fano-s, u pá nevoja të ngarkohej me të drejtat e njëj «*governatori*» të Fano-s në vendin e Arjanitit një tjetër personalitet që të mujte me i bâ ball gjendjes së rrezikshme, e cila shpesh herë ishte kërcnue të dëbonte një herë e mirë «*il governatore perpetuo*» të Papës. Papa Luani i X pat vendosë t' i a lëshonte sundimin e qytetit Fano nipit të vet të vetëm Lorenzo dei Medici, të birit të të vëllaut Pietro, të cilin e kishte pasë emnue Dukë t'Urbino-s. Me dokumentin papnuer të ditës 4 nënduer 1516 i u dha qeverimi («*governo*») i Fano-s nipit të Papës, Dukës të rí t'Urbino-s, i cili me një letër të shkrueme nga Roma me 5 nënduer t'atij vjeti i a njoftonte Konstantin Arjanitit (123) vendimin papnuer dhe i bante me dijte se kishte pasë emnue si përfaqses të vetin *dottore* Bernardino de' Arciani-n, i cili sot e mbrapa dō të mbarështronte të gjitha punët.

Francesco-Maria della Rovere, i cili kishte pasë qënë pushue nga puna si Dukë i Urbino-s, po përgatitej për një kundërsulm dhe kishte pasë mbledhë fuqí të mjafta për të largue nga princnija dhe nga Fano padronin e rí. N'ushtrín e tij gjindeshin edhe Stratiotë Shqiptarë (124), ndërmjet të cilvet edhe asish që kishin farefisni me Arjanitin. Mbas një sëmundjeje së rëndë, me 28 prill 1519 vdiq Lorenzo dei Medici; vdekja e këtij solli menjisherë ndryshime edhe në qeverimin e qytetit të Fano-s. Luani i X emnoi me dekretin e 24 gushtit 1519 si komandant të përgjithëshëm të qytetit kardinalin Giulio dei Medici, i cili mâ vonë pat qënë bâ Papë me emnin Klementi i VII. Por kúr Kardinalli me 19 nënduer 1523 pranoi ket emnim të radhës s'ulët kundrejt shkallës së naltë papnore, Konstantin Arjaniti doli përsëri në shesh. Mâ së pari ai e la vendbanimin e vet në Romë dhe shkoi e nguli në Rocca di Fano, prej kah ushtroi sundimin si përpara. Në këtë ndërkohë pat blé në Qytetin e Amshuem një pallat, prej kah jipte urdhna si princ. Në Fano ngrejti popullsin e vendit t'acarueme kundra përfaqsesit të vet, një farë Gualberto Senili; mbrenda pak kohe e hoq qafe dhe u përpoq të shtënte në dorë sundimin e administratës së vendit. Aso kohe sundimtari nuk baronte mâ në Rocca di Fano, që ishte e kërcnueme, por ishte tërhjekë në Kështjellin e pa-arrijshtëm të Montefiore-s,

nji qytet i vogël jo fort larg nga Rimini (125), qi i kishte pasë qënë shenue bashkë me Mondaino-n me vendimin papnuer të 21 qershorit 1524. Ky Kështjell ishte shum i mprojtun e nuk mund t'arrihej lehtë nga populli i zemruem. Ky, mâ në fund, gjeti në vjetin 1526 një rrugëdalje, d.m.th. qi Republika e Shën Markut të ringjallte marrëdhënjet dhe lidhjet e vjetra me Fano-n, qi kishin qënë qitë në harresë, dhe t'i proponohej Venedikut drejtpërsëdrejti sundimi mbí qytet. Me një shkresë të 15 korrikut 1526, qi gjindet edhe sot në Archivio secreto Priorale në Fano, Doge-ja Andrea Gritti thotë se i ká dhânë udhëzimet përkatse «*al magnifico e diletto nobile nostro Domino Constantino Arniti*» dhe se i këshillonte banorët e Fano-s qi mos t'i a mohojshin ndigjesën kishës: «*Vogliate unanimi perseverare nella solita fede e devotion vostra verso la Santa Sede Apostolica sotto la obediencia del prefato Signor Constantino*». Në fund A. Gritti nuk harron të përmendë se vijon gjithnji dashamirsija e tij («*benevolentia*») kundrejt Konstantin Arjanitit (126). Në ketë mënyrë rá poshtë një herë e për gjithmonë qellimi për të ndrrue kryesundimin kishtar me një tjetër lajk të Serenissima-s...

Montefiore edhe paskëtaj mbeti vendbanimi i përherëshëm i Arjanitasit dhe i së shoqes së tij Francesca. Dý nga vajzat e tija jetuen në gjendje të mirë ekonomike aty afër. Në vjeshtën e vjetit 1529 Fano ndrooi zot për një kohë të shkurtë (127) me një kapár prej 5000 dukatesh, mbasi qi dhandrri i Konstantinit, i emnuem prej këtij, i quejtuni Rinaldo degli Ottoni, qi ishte zot i Matelica-s në Marche-t, pat qënë përpjekë pá asnji dobí, si agjent i Konstantinit, për të provue fatin (128).

Shka pat ngjá me pronat e tija në Piemonte, të cilat në vjetin 1521 i patën qënë njoftë zyrtarisht, nuk mund të thohet me pak fjalë; do t'ishte nevoja të flitej për secilën veç e veç. Dokumentat «*Protocolli del Monferrato*», qi gjinden të ruejtun n'Arkivin Shtetnuer të Torino-s, deri sot kanë mbetë, po thuejsë, të papërdorëshëm edhe përsá i përket Konstantin Arjanitit. Me Bashkin e Refrancore-s (25 km në jug-verí të Casale-s), e vetmja bashtinë e cila mund të dokumentohet se ká qënë pronë e familjes asë e farefisit t'afërm qysh prej 12 të marsit 1492 deri në vjetin 1508, feudali i vendit gjindej në disá mosmarrëveshtje qysh prej vjetit 1508, kúr planet e tija me Belgrado-n në Friuli shkuen huq, nuk u sendërtuen (129). Me 29 dhjetuer 1515 «*Constantino Comneno, Principe di Tessaglia, Duca di Macedonia*», ngarkon Grekun e përmendun Janus Laskaris (130), të cilit Italia lipset t'i jetë mirënjofhtës në fushën e studimevet humanistike, ashtu edhe një patric milanez me emnin Dionisio, me përfaqsimin e interesavet të tija pranë Markgrafit Guglielmo di Monferrato. Vjeti 1521 solli gjithfarë ndryshimesh në pronat e tija në krahinë e Markgravjatit. Me 15 mars Mercurino Arborio di Gattinara (1465 deri 1530), Kanceljeri i Madh i Karlit të V (131), merr në dorzim shtëpín e Konstantin Arjanitasit në qytetin Casale di Monferrato, por pak javë mâ vonë (20 prill dhe 8 gusht) i jipet Arjanitit përsëri prona Refrancore (132), mbasi i patën qënë dorzue rishtas me 16, 18 dhe 20 mars pronat Rivalta, Barnida, Ozzano Monferrato, Terruggia, Moransengo dhe Tonengo (133). Me



**Shkresa e Perandorit Frederikut të III Papës Inocencit të VIII.**

Pordenone (Friuli), 1489, VII 11, në lidhje me ndihmën për të vejën Pietrina Arjaniti  
Arkivi Shtetnuer në Venedik (kolekcioni L. Podocataro, b. 5, Nr. 267).

sá duket, të gjitha këto prona i patën rrëshqitë prap dore në një kohë të shkurtë. Me të vërtetë prona Refrancore i u dorzue me 20 fruer 1532 (respektivisht me 13 maj 1533) të birit të Konstantinit, i cili më vonë (1547) i a dorzoi, asë që shtërngue t'i a dorzonte farefisit të vet Leonardo Tocco-s. Në vjetin 1515 e kishte pasë zotnue ketë pronë, mbas gjase përkohësisht, me ndërmjetsin e Perandorit Maksimiljanit të I, i favorizuem i këtij Fernando Tocco, ungji i Leonardo-s.

Me 29 prill 1530 ai «*del corpore languido et infermo*» thirri notarin e Montefiore-s, Lorenzo Leardini-n, dhe, në praninë e shumë dishmitarve, bëni testamentin e fundit. Ky dokument, prej dy faqesh, pat qënë zhdukë për një kohë të gjatë (134) dhe vetëm me 25 mars të vjetit 1960 doli përsëri në shesh (135). Si zbatues i testamentit është caktue nipi i tij Franceschetto della Rovere (epishkop i Volterra-s qysh prej vjetit 1514, dhe pastaj prej vjetit 1530 krye-epishkop i Benevento-s), i biri i së motrës së tij Katerinës. E pat kujtue të motrën, por pat caktue si trashigimtare të vërtetë të shoqen e vet Francesca di Monferrato ashtu edhe djalin e vet «Arnito», të cilët më vonë, simbas dekretit papnuer të 14 majit 1530, morën në dorë, natyrisht vetëm për një kohë shumë të shkurtë, zotnimin e Fano-s.

Me 8, jo me 1 maj, sikursë zakonisht thohet (136) «*Constantino Comnino principe di Macedonia e di Fano e Montefiore perpetuo gubernatore*» — kështu e quen veten në testament — më shumë se shtatëdhjetë vjeç i mbylli sytë në gjumin e përherëshëm. Trupi i tij, mbas shtytjes së së vejes asë të të birit, që shpërngulë në Romë dhe që shti atjë në Kriptën e Kishës Basilica Santi Apostoli. Mbishkrimi i vorrit pat qënë botue në fundin e shekullit 16 nga Lorenz Schradder-i (137) nga Halberstadt në librin e tij «*Monumentorum Italiae quae hoc nostro saeculo et a Christianis posita sunt, libri quatuor*» (Helmaestadii 1592) në faqen 124 b (138). Ky mbishkrim është plot me gabime në të dhënat e kohës dhe sidomos n'ato historiket. Teksti është ky qi vijon:

CONSTANTINO COMNENO MACEDONIAE PRINCIPI, ACHAEA DUCI, QUI CUM PATRE AMISSO XII. ANN: NATUS AUITIS REGNIS A TURCIS PULSUS ESSET. ANIMI MAGNITUDE FORTUNAE INIURIAM CONFUTAUIT, BELLICISQUE STUDIIS MAIORUM SUORUM AMPLITUDINEM ADAEQUAUIT, PRIMUM A MAXIMILIANO IMPERATORE ITERUM AB EODEM MAXIMILIANO IULIOQUE SECUNDO PONT. MAX. ATQUE ALOYSIO GALLORUM REGE AMPLISSIMIS EXERCITIBUS PRAEPOSITUS, OMNIBUS IMPERATORIS VIRTUTIBUS SUMMAM GLORIAM ADEPTUS EST.

ARANITUS FILIUS PATRI OPT: MERIT: POS. VIX: ANN: LXXIII. DECESSIT CALEND. MAIJ: ANNO MDXXXI.

Mbishkrimi dhe vorri i Konstantin Arjanitit nuk gjinden më në Basilikën Dodici Apostoli në katedralen e Konventualvet Françeskanë në Romë. Së paku mue nuk më qe e mundun me 13 prill 1955 t'a gjetshem vorrin e Konstantinit në kriptën e sipër-përmendun me gjith ndihmën qi më dha Padre Gallo, o.f.m. conv. me dritë artificja-

le (139). Si duket, mbishkrimi dhe vorri janë zhdukë në përmbytjet dhe në termetet që gjatë shekujvet e kanë dâmtue këtë kishë (140).

Djali i vetëm i Konstantinit, që quhej Arianit («*Ariano*»), i ka bërë një vorr jo vetëm t'et, por edhe kushrinit të vet, kryepishkopit të Benevento-s Franceschetto della Rovere, i cili vdiq më 22 kallënduer të vjetit 1549. Edhë mbishkrimin e vorrit të këtij, Lorenz Schrader-i na e jep në veprën e vet (faqe 125 a); po e çekim këtë vetëm për të tregue se edhë djali i Konstantinit, kurrë është fjala për të naltue farefisin, nuk këqyrte aq hollë të vërtetën historike. Në ket mbishkrim Princi i Kishës quhet «*Julij II. Pontif. Max. ex fratre Nepoti, ex matre vero ex nobili Comiennorum (!) Graeciae Imperatoris familia*», të cilit ai, farefisi («*consanguineus*») «*Aranitus Comenus Macedoniae princeps*», i a kushton ket përmendore në mirënjohjesi e dashurisë.

Arianit-i, i mbrâmi i fisit të tij, pat një jetë fatmjerë. Ky pat qënë më në fund (141) komandant (*prefetto*) i ushtrisë papnore dhe në luftimin e përgjakshëm ndërmjet Julit të III dhe Oktavit Farnese në Torchiera, jo larg nga Parma, e humbi jetën tue luftue natën e 16 nëndorit 1551 (142). I vdekuni, mbas kërkesës së Ottavio-s Farnese, që shpërngulë në Parma, që balcme dhe që vorrue në Kishën e Kuvendit San Giovanni Battista. Ndërkaq nuk është rrujtë asnjë gjurmë e vorrit të tij (143). Me këtë u mbulue me dhë më i mbrâmi Arjanit (144), dhe me këtë u shue farefisi mashkulluer i familjes.

Tue qënë se lajmet mbi të bijat e Konstantinit, d.m.th. mbi të motrat e Arjanit-it, janë të meta dhe jo pa gabime — K. Hopf-i (145) është i vetmi që flet për këto grë e për fatet e tyre —, ndoshta i a vlen barra qirân t'i përsërisim këtu lajmet e plotsueme dhe të qortueme që na jep Hopf-i (*Chroniques Gréco-Romaines*, faqe 535).

Vajza më e madhe, Andonika, u martue me kontin titullar të Zante-s dhe dhespotin titullar t'Artës Carlo III Tocco, të birin e dhespotit Leonardo III, i cili e pat me gruen e parë Milicën, të bijën e princit të Serbvet Lazar Branković-it. Nga kjo martesë leu Leonard IV, i cili në vjetin 1547 na del si zotnues i Refrancore-s dhe që e vijoi fisin Tocco gadi deri në kohët e sotme. Vëllau i tij, më pa kunorë, që Ferrante Tocco, i cili në vjetin 1515 pat pasë si dhuratë Refrancore-n nga perandori Maksimiljan, pranë të cilit gëzonte besim të plotë. Vdiq në vjetin 1535. Tre bijt e tij vdiqën fëmij. Carlo III Tocco vdiq në Romë, ku jetonte me një shpërblim papnuer, rreth vjetit 1518, kursë e shoqja i vdiq vonë në vjetin 1544. Nga pronat e tija, që i ati Leonard i III i pat pasë n'Italín e jugut mbas ikjes nga Turqit, d.m.th. Calimera dhe Briatico (në Kalabrin), më vonë (në vjetin 1495 nga mbreti Karli i VIII i Francës) edhë prona në Monòpoli (Apulí), të bijt e tij nuk trashiguen kurrëgjâ mbas vdekjes së tij që ngjau rreth vjetit 1499.

Vajza e dytë, Penthesilea (Πενθεσίλευα), e quejtun me ket emën simbas mbretreshës s'Amazonevet që pat qënë vrá nga Akili, mori për burr Lekë Dukagjnin, pinjuell i një familjeje së përmendun shqiptare (146), e cila mbas pushtimit të Shqipnis nga Osmanët, pat qënë hjedhë nga ana e tyre tue u bërë musulmane, asë pat

kalue n'Italí dhe pat zânë vend në krahinën e Ancona-s. Lekë Dukagjini ishte i biri i Stefan Dukagjinit, qi pat ikë n'Apulí, dhe i Angjelinës, e bija e Zotit të Pologut Alessio Spanit (+1495) dhe e Lizabetës, e bija e njëj prínci serb me emnin Gjergj (147). Ky Alessio pat pasë një vëllá má të vogël Andrén, i cili pat qënë martue për herën e parë me të motrën e Konstantin Arjanitasit Katerinën. Nga martesë e Lekë Dukagjinit me Pentesilén lindi një djal me emnin Niccolò ashtu edhe dy bija, Francesca e Marija. Për këta nuk dihet kurrgjá. Gjithashtu nuk kemi lajme as mbí jetën e Lekë Dukagjinit dhe të së shoqes.

Vajza e tretë Ippolita (Ἰππολύτη, prá një tjetër mbreteshë Amazonash), pat qënë martue dy herë; për këto dy martesë kemi lajme të mjaftueshme prej hetimevet të bame nga Giuseppe Gerola «*Ippolita Comnena, contessa di Verucchio e Scorticata*» (Ravenna 1913, 20 faqe) (148). Ajo pat lé rreth vjetit 1507 dhe pat vdekë me 11 tetuer 1566 në Meldola jo shumë larg nga Forlì. Në vjetin 1525 u lidh në martesë për herën e parë me Zanobio-n de' Medici (lé në vjetin 1483), të birin e Antonit, nga një degë e dytë e Familjes së Fjorentin-ve. Në vjetin 1525 ky bleu për 1650 dukatë kontét Verucchio dhe Scorticata (në krahinën e Rimini-t), të cilat ai, bashkë me zotnimin e Bertinoro-s, qi e kishte pasë në vjetin 1531 mbas vdekjes së vëllaut Alberto (149), i a la trashigim së shoqes Ippolita me të cilën s'kishte pasë fëmij; ky vdiq në vjeshtën e vjetit 1530, dhe u vorrue në Kishën e Françeskanvet në Villa di Verucchio, ku ásht rrujtë endë sot pllaka drejtkândse e vorrit. Mbishkrimi i vorrit gjindet ke G. Dehò «*Una gita a Verucchio e a Forlì*» (Modena 1880), faqe 9 ashtu edhe ke Gius. Gerola, vepër e çekun, faqe 6 shenim, një riprodhim i keq në faqen 7. U martue për së dyti me 2 fruer 1532 në Rocca di Verucchio me Lionello-n Pio di Carpi, kont i Verucchio-s, i cili má parë (rreth vjetit 1492) kishte pasë marrë për grue Marín, të bijën e Bernardit Martinengo. qi qysh prej vjetit 1530 jetonte në Romagna si guvernatore i Papës, ku kishte edhe zotnimet e Sarsina-s dhe të Meldola-s. Prej kësaj martesë së dytë me Ipolitën lindën sèpaku tre (150) djelm. Konstantini, Manfredi dhe Alberti qi leu me 25 shtatuer 1545 në Meldola (të krahasohet dokumenti te Gius. Gerola, vepër e çekun, faqe 16), dhe qi i vetmi trashigoí pasunin e t'et. Ky e vijoi fisin e të fuqishmit Pio di Carpi me martesën qi bâní me Ippolita dei Rossi (Parma), vdekun në vjetin 1599, të bijën e Giulio Cesare, kont i Caiazzo-s. E bija Lucrezia, lindun rreth vjetit 1540, mori për burr në fundin e frorit 1562 Paolo Sforza, markezin e Proceno-s, të birin e atij Bcsio Sforza-s, kont i Santafore-s, nga një brez i dytë i Familjes së përmendun. e cila dikúr pat dhânë «*duchi*» qi patën zotnimin e Milano-s e të Pesaro-s. Lionello Pio di Carpi vdiq plak (94?) me 20 kallënduer 1571; nuk qe vorrue, simbas vullndetit të tij të fundit (151), në Kishën Santa Maria dell'Ulivo në Meldola, por përpara Kishës s'atjeshme San Rocco; krh. Gius. Gerola, vepër e çekun, faqe 9. shenimi 3. Le të krahasohet edhe përskrimi i hollësishëm i Paolo Mastri-t «*Lionello Pio da Carpi in Meldola*» (1531-1571), në «*Atti e Memorie della Deputazione di Storia Patria per l'Emilia e la Romagna*», VI (Bologna, 1941), faqe 207 deri 230, ashtu edhe



«*I Veneti e i Principi Pio da Carpi in Meldola*», ibidem, V (Bologna, 1940), faqe 113-131. Disá degë të këtij fisi ruejnë edhe sot emnin si Principi Pio di Savoia.

E katërta bijë, qi vdiq përpara vjetit 1531, e quejtuna Polisená (Πολύξενος, e bija e Priamit të legjendës greke), qe martue në vjetin 1524 me Rinaldo-n degli Ottoni në Matelica, një zotni i pasun dhe i fuqishëm në Marche-t. Nga kjo martesë lindi një djal me emnin Pirro (Pyrrhos, mbret i Epirit dhe aftos legjendár i Shqiptarvet), i cili u martue me Livjen, të bijën e Cesare degli Ottoni dhe pat nándë fëmij. Njëni prej djelmve të tij qe quejtë «*Aranito*». Fisi i Ottonvet në Matelica u shue në vjetin 1757. Këta patën sundue prej vjetit 1394 deri në vjetin 1578 si «*vicari della chiesa*» dhe si tiranë në Matelica, ku ruhet edhe sot pallati i tyne.

E pesta vajzë, Deianira (Δηϊανειρα, fytyrë legjendare greke, e shoqja e Herakliut) pat qënë martue dy herë me pjestarë të Familjes së përmendun milaneze Trivulzi. Herën e parë mori për burr Gasprin Trivulzio, i pasun pronash, vdekun në vjetin 1549. djalin e madh të të pasunit Erasmo (152); për herën e dytë u martue me kushrinin e burrit në të tretin brez Giorgio Conte Trivulzio nga brezi i kontit Melzo. Ky Giorgio kont Trivulzio pat qënë një Condottiere, i cili për një kohë të gjatë pat qënë në shërbim të Republikës së Venedikut, i shtým nga mbreti Filip i Spanjës (letër e 26 majit 1557 Kardinalit Trivulzio të Trento-s, një vëllá i Gjergjit T.). Si «*condottiero d'homini d'arme*» në shërbim të Republikës mirrte një shpërblim vjetuer prej 500 dukatësh (153). «*Licenza di congedo*» mban datën 19 shtatuer 1565 (154). Gjergji vdiq pá lânë fëmij mbas vedit me 19 kallënduer 1583 në moshën 66 vjeçare, kursë e shoqja i kishte pasë vdekë má përpara në vjetin 1572. Krejt pasunija toksore në Locate Triulzi (13 km në jug të Milanit) dhe Triulzo vetë i takoi, simbas testamentit të 27 prillit 1580, të nipit Paolo Alessandro.

Trivulzi-t patën lidhje familjare edhe me një tjetër pjestár të Familjes s'Arjanitasvet. Orazio Trivulzio (+1573), i biri i Gian Fermo-s (+1546), prej fisit të kontit Melzo, mori për grue në vjetin 1568 Andronikën Comnena, të bín e «Princit të Macedonis», e cila n'aktet e dokumentat shenohet shprehimisht si e mbesa e Dejanirës. Kjo prá pá tjetër ásht e bija e të mbrámit Arjanit, e cila këso dore tregohet si e martueme; mbas vdekjes së shpejtë të të shojt të parë u martue me një farë Giorgio Secco, të birin e Antonio S., ndoshta një fisnik milanez.

Vajza e fundit qe Elena (Helene, Ἑλένη, e bija e Zojzit), për fatin e së cilës nuk kemi shumë për të thánë. Kjo u martue në vjetin 1546 me Juan-in Conte de Luna, kapidan i kështjellit të Milanit, dhe si duket, do të ketë vdekë aty rreth vjetit 1563. Prej mbarimit të këtij vjeti Elena pat marrë nga këshilli kontrollues mbretner në Paris një shumë muejore vejnije prej 100 lb. Kjo grue thirret nga Ducange (155) në një dokument «*Hélène Comnène Comtesse de la Lune, veuve de feu Castellan de Milan*». Në vjetin 1562 i biri i Kapidanit të Kështjellit, i quejtuni Giacomo asë Jaime, pat

marrë nga Franca shumë e 201 lb. Nuk mund të thuhet se kúr ká vdekë Elena de Luna as nuk dihet në se pat pasë të tjerë fëmij përveç Giacomo-s qi përmendëm. Ndoshta Juan de Luna i përkiste Familjes së kontavet spanjollë de Luna, qi sundojshin në Fuentidueña dhe qi me anën e Catalina-s de Luna ishin farefis i afërm me Valois-t. Nji Alvaro de Luna pat qënë nën sundimin e Karlit të V komandant në Monferrato (156) dhe má vonë komandant i kështjellit të Milanit; mund të jetë se ky ástht i ati i kontit Juan.

Nga të gjitha këto shifet se me përjashtimin e familjes Tocchi, e cila jetonte në krahinë e Romës e të Napoli-t, të gjitha familjet e tjera, ku patën martue të bijat e Konstantinit, e kishin ndëjën e vet n'Italín e Sipërme, dhe, gadi të tana kishin prona të pasuna dhe pasuní të madhe. Mund të flitet gadi-gadi për nji forcë familjare të Arjanitasvet, qi pat nisë të sajojhet në Romagna dhe në Marche-t, por edhe në Milan e në rrethet e tija. Me shuemjen e brezit mashkulluer, ky fis bujár shqiptár, dikúr shumë i përmendun, mbaroi keqas.


### Shtesë në lidhje me vorrin e Konstantin Arjanitit

E pata krye përshkrimin e lajmevet mbí vorrin e Konstantin Arjanitasit, kúr nji rasë e papritun më vûni në dijení se vorri i tij nuk gjindet në Basilica SS. Apostoli, sikursë ká qënë se pohue gjithnji me kâmbëngulje nga Lorenc Schrader-i (1592) dhe Du Cange (1680), por në kishën Sant'Agostino në Romë. Tue shfletue veprën e madhnueshme « *Iscrizioni delle Chiese e di altri Edifici di Roma* » të Vincencit Forcella, blênin e III (Roma 1874), faqe 40, Nr. 117, takova mbishkrimin e vorrit qi gjindet në kishën e sipër-përmendun, i cili ndryshon në disá hollësi nga ai qi na jep Lorenc Schrader. Mbishkrimi prá ástht ky:

### D . O . M.

CONSTANTINO COMNENO MACEDONIAE PRINCIPI  
ACHAIAE DVCI QVI CVM PATRE AMISSO DVODECIM  
ANNOS NATVS AVITIS RECNIS A TVRCIS PVLSVS  
ESSET ANIMI MAGNITVDINE FORTVNAE  
INVIRIAM CONFVTAVIT BELLICISQ STVDIIS  
MAIOR SVOR ANPLITVDINEM ADAEQVA  
VIT AC PMV A MAXIMILIANO IMPERATORE  
ITERV AB EODE MAXIMILIANO IVLIOQ SECVNDO  
PONT . MAX . ATQ ALOYSIO GALLOR REGE AM  
PLISSIMIS EXERCITIB' PRAEPOSITVS OMNIB'  
IMPERATORIIS VIRIVTIB' SVMĀ GLORIAM  
ADEPTVS EST . ARANIVS FILIVS PATRI OPTIME  
MERITO . P . VIXIT ANN . LXXIII . DECESSIT  
POSTRIDIE NONAS MAII M . D . XXXI .

Ky përpilim kushtimi mund të kundrohet më i sigurti. Shenimi i ditës së vdekjes jipet me «*postridie Nonas Maii*» dhe kjo është data e sigurtë e vdekjes, d.m.th. 8 maji. Vjeti 1531 edhe këtu është dhënë gabimisht, pse lipsej t'ishte, sikurse dihet, 1530 (krahaso më sipër).



Kështjelli i Montefiore-s.

Duket se V. Forcella nuk e ka pá me sý të vet mbishkrimin në kishën e sipër-përmendun, pse ai mbështetet në burimin (*dall'*) e dorëshkrimit të njëj *Anonimo Spagnuolo në Fondo Chigi* (nr. i vendosjes: I, V, i67, fleta 8<sup>a</sup>) (157) në Bibljotekën Vatikane, por merr parasýsh edhe veprën e Lorenc Schrader-it, por pá përmendë, se ky e mbas këtij Du Cange shenojnë një kishë tjetër. Por prap qindron pyetja: a thue mund të jetë qi vetëm pllaka e vorrit me mbishkrimin e vërtetë të ketë qënë shpërngulë mbas ndonjij përmbytjeje shkatrruese të Kishës SS. Apostoli në Kishën e Shën Agostinit? A thue mos është fjala vetëm për një pllakë kujtimore, dhe jo për një rrasë vorri? Të gjitha këto duhej të vërtetoheshin në vend, gjá qi unë nuk pata mundësi të hájshem. Simbas *cod. Chigiano*, pllaka e gurit gjindej aso kohe «*supra fornicem cuiusdam sacelli*».

Rimini, Rrëshajë 1960.

E përkthei nga gjermanishtja **KARL GURAKUQI**

F U N D

(123) Dokumenti gjindet n'Arkivin Shtetnuer të Firenze-s « *Carte Stroz.* » IX, 188, në të cilin pat qënë mbështetë Ludwig v. Pastor « *Geschichte der Päpste* », IV/1. 5-7 (Freiburg 1923), faqe 358, shenimi 2.

(124) Simbas Pietro-Maria Ammiani-t, vepër e çekun II, 116, gjincoeshin n'ushtrin e Federikut da Bozzolo edhe « *Costantino Boccali Greco* » ashtu edhe « *Andrea Bua Albanese* ».

(125) Me 25 mars 1960 pata rasën e dishrueme të shkojshem nga Rimini në Montefiore (Conca), ku kryetari i bashkis i vendit, Giov. Turrini, bashkë me sekretarin bashkijak, Nello Morelli-n, më dha mundësin të vizitojshem Kështjelin e madh Malatesta, të rindërtuem, ku pat vdekë Konstantin Arjanitasi. Këtyne si edhe Bruno Palazzi-t të E.P.T. në Rimini, qi më vûni në dispozicion automobilin, ju paraqes falënderimet e mija të posaçme. Në Bashki gjindet-nji Arkiv i pasun qi mërrijnë deri në shekullin 14, dokumentat e të cilit sigurisht do të na jipshin ndihmë të madhe edhe për historin e K.A.

(126) Shkresa e Andrea Gritti-t gjindet tekstualisht në P.-M. Ammiani, vepër e çekun, II (Fano 1751), faqe 135.

(127) Ky ndrrim i përkohëshëm pat qënë shfuqizue me dekretin papnuer të dhânun në Bologna me 30 tetuer 1529, kûr Papa Klementi VIII me nji dekret të shkurtë të 23 dhetorit 1529 e pat përsëritë gjendjen e përparshme me arsyetime të pathemelta. Krahaso për ketë punë P.M. Amiano, vepër e çekun, II (1751), faqe 137 e vijanos.

(128) Konstantini kishte pasë emnue si përfaqësues të vetin në Fano dhandrrin e vet Rinaldo degli Ottoni me 26 korrik 1524. Ky dokument bân datën: « *Datum Romae in Edibus n[ost]ris Die XXVI Julij MDXXIII; Isidorus almogaverus secr.* »; prâ, si shifet, shkruet me nji stil të naltë princnuer. Nënshkrimi âsht ky qi vijon: « *Constantinus Cominus Princeps Macedonie* ». Kopja gjindet në fletën 166 të *Registri V* n'Arkivin e qytetit në Fano.

(129) Arkivi i shtetit në Torino: *Protocolli del Monferrato*, vol. XXX, fleta 37.

(130) Natyrisht B. Knös-it do t'i ketë rrëshqitë ky lajm i rëndësishëm për historin e gramatikantit të njoftun Janus Laskaris, qi pat vdekë me 7 dhetuer 1534 në Romë (krh. *Rhein. Museum LXV* [Frankfurt a.M. 1913], faqe 318 dhe Giov. Mercati *Opere Minori*, III [Città del Vaticano 1937], faqe 185). Guri i vorrit të këtij në Kishën-Santa Agata në Suburra na bân të njoftuna vuejtjet e mërgimit të tij. Përshkrimin t'onë do t'i a dijmë veprës « *Un ambassadeur de l'hellénisme — Janus Lascaris — et la tradition gréco-byzantine dans l'humanisme français* » (Uppsala-Paris 1945). Dokumenti gjindet n'Arkivin shtetnuer në Torino « *Protocolli del Monferrato* », vol. 21, A. Torre, fleta 46.

(131) Krh po aty, vol. 19, fleta 101. Njikohësisht shumica e pronavet, qi K. Arjanitasi i kishte pasë marrë në dorzim në vjetët 1492 (Ozzano, Rivalta, Terruggia) dhe 1499 (Moransego, Piazza afër Torino-s, Refrancore) ndoshta si dhuratë martese, me përjashtimin e pronës Tonego, i u dhanë Kanceljerit të Madh (së paku simbas Fr. Guasco-s « *Dizionario feudale degli antichi stati sardi e della Lombardia* », III [Pinerolo 1911], faqe 1197, 1337, 1625 ashtu edhe 1108, 1243, 1644). Mbas hamendjes, këto u sekvestruen nga ana e perandorit Karlit të V.

(132) Për Refrancore dhe pronarët e saj krah. edhe Francesco Guasco-n « *Dizionario feudale* » III (Pinerolo 1911), faqe 1322; vetëm se këtu janë harrue disa bashitina; krah. edhe Goffredo Casalis « *Dizionario geografico-storico-statistico-commerciale degli Stati di S.M. Re di Sardegna* », XVI (Torino 1847), faqe 158-163. Biblioteka Civica Vittorio Alfieri në Asti më pat këshillue edhe veprën e Lodovico Vergano « *Vicende Storiche di Refrancore* » (Alessandria-Casale Monferrato, o.J.) faqe 65. Kështjelli Refrancore pat qënë prishë gjatë pushtimit francez. Në vjetin 1829 familja Tocco ia shiti rrënojat prokuratorit Clemente Maggiora.

(133) Krah. Benvenuto Sangiorgio vepër e çekun, faqe 365. - Përsá i përket « *Barnida-s* », nuk mundem me e përcaktue, me gjith ndihmën e veprës së Fr. Guasco-s.

(134) Don Gaetano Vitali kishte dijeni për veprën « *Memorie storiche riguardanti la Terra di M. Fiore* » (Rimini 1828), faqe 340, me gjith këtë Giuseppe Gerola e ka kërkuë « *inutilmente* », sikursë shkruhet në « *Ippolita Comnena Contessa di Verucchio e Scorticata* » (Ravenna 1918, per nozze Echia-Romagnoli Rimini, tetuer 1918, botue në 60 kopje). Gjindet ndërmjet « *Monumenti Riminesi autografi raccolti e conservati da Michelangelo Zanotti, notaio collegiato di Rimini* » në vëllimin XIV në Biblioteka Civica Cambalunga në Rimini. Në të njëjtin vëllim pata takue edhe shkrime të tjera në përkatsi me Arjanitin, d.m.th. XIV/22 me 6 mars 1528: Konstantin Arjaniti i jep një diftesë të të hollash në Montefiore Ettore-s di Rinaldo da Matelica; XIV/73 flet për prishjen e paktit të martesës ndërmjet vajzës së Konstantinit Ippolita, konteshës së Verucchio-s e të Scorticata-s me Lionello Pio-n, zotin e Carpi-t, të Sarsina-s e të Meldola-s. Për historin e vendit të Montefiore-s është me rëndësi një dokument i 12 prillit 1523, ku jipet pëlqimi i themelimit të njëj Kuvendi Françeskanësh në « *Monte Biforco* » përpara Montefiore-s, i cili gjindet edhe sot. Me 28 gusht 1523 emnohet Podestà i Monferiore-s, me pëlqimin e « *governorit* » të Fano-s, një farë Stefano Angeli.

(135) Krah. P. Amiani-n, vepër e çekun, II. faqe 138, ashtu edhe Luigi Tonini-n « *Rimini dal 1500 al 1800* », VI (Rimini 1887), faqe 190. Dekreti duket se pat qënë shpallë me 14 dhe jo me 11 maj 1530.

(136) Mbishkrimi latinisht i vorrit në ribotimin e L. Schrader-it na jep ditën 1 maj 1531 si ditën e vdekjes, A. Gegaj, vepër e çekun, faqe 58 njëzetegjasthtë nândorin 1528. Të gjitha të dhënat, edhe ato mbí të birin Arjanit, janë të ngatrueme.

(137) Laurenz (Lorenz) Schrader-i, lindun me 14-III-1537 në Halberstadt, vdekun me 28-VI-1606 në Osnabrück, nuk ka qënë nderue sá duhet në pikëpamje shkencore. Ky pat qënë vorrue në Kishën e atjeshme të Shën Mëris; doktor drejtësiye dhe diplomacije, kont i Palatinatit dhe këshilltár i epishkopit në Osnabrück, qysh prej vjetit 1594 zot i Bringenburg-ut në Wersen, babë gjashtë fëmijsh (tre djelm e trí vajza) me të shogën Kristinë, bijë e familjes Hermeling (1540-1607). Krahaso tash për tash E. Fink-un në ADB (Leipzig 1908), faqe 178 ashtu edhe revistën familjare « *Schrader-Archiv* », III [= 1929/32] (Berlin 1934), kumtim nga Friedr. Schrader (+1937). Mbí mbishkrimet e mbledhuna prej tij n'udhëtimet e shumta nepër Itali dhe që gjinden në veprën e rrallë « *Monumentorum Italiae quae hos nostro saeculo et a Christianis posita sunt, libri quatuor* » (Helmstaedii 1592), le të kraha-

sohen lajmet e hollësishme të Karl Steinkaker-it (1872-1944) « *Italienische Studienfahrt eines einés Ostfalen und ihre Auswertung zur Zeit beginnender Barockgesinnung* », në: « *Braunschweigisches Jahrbuch* », III, vëllimi 3 (Braunschweig 1941/42), sidomos faqe 91-96. - Zotit Wilh. Schrader-it i paraqes edhe këtu falënderimet e mija të përzemërta për lajmet qi pati mirsin të më jepte.

(138) Prej kësaj vepre të Lorenz Schrader-it, Du Cange e ka theksue mbishkrimin në « *Stemma* »-t e vet (vepër e çekun, faqe 369).

(139) Simbas njëj lajmi të Curia Generalizia dell'Ordine dei Frati Minori Conventuali (Roma, Piazza S.S. Apostoli, 51), kërkimet e bame për mue nga Fretnit e Urdhnit nuk kanë dhënë asnj gjurmë se ku mund të gjindet vorri i Konstantinit.

(140) Bazilika e Dymbëdhëtë Apostujve qysh prej vjetit 1472 për një kohë të gjatë pat qënë nën patronatin e Familjes della Rovere, e cila ndërtoi një farë mauzoleu për pjestarët e familjes në presbiterin e kishës. Një pjesë e këtyne përmendoreve vorresh, ndër të cilat ajo e njëj farefisi t'afërm të Konstantin Arjanitit, e epishkopit të Savona-s Giacomo Giuppo della Rovere (+ 1510), është zhdukë tash shumë kohë. Trupi i K.A. në ketë ndërkohë nuk pat qënë vorrue këtu, por në podrumin e kishës. Krh. A. Bonelli-n « *Memorie storiche della Basilica Constantiniana dei S.S. XII Apostoli* » (Roma 1879) ashtu edhe P. B. Malvasia-n (Boselli) « *Compendio storico della ven. Basilica dei SS. Dodeci Apostoli di Roma* » (Roma 1665), ku nuk gjindet asgj mbishkrimin e K. Arjanitasit.

(141) Mbi jetën e tij të përparëshme dhe mbi martesën e tij nuk kemi kurrgjâ për të thënë.

(142) Mbi ditët e fundit të tij flet hollësisht kanceljeri ipeshkëvnuer Cristoforo della Torre në Parma në Ditarin e vet qi mërrinjë deri në vj. 1586 « *Bellum Parmense decima die Junii 1551 ceptum, et vigesima prima Maii 1552 completum... ad formam Diarii* », origjinali i të cilit ruhet në Biblioteca Palatina në Parma (dorëshkrim 1128; kopje 1184, 74). Është prâ fjala jo për Torchiana-n n'afërsit e Salerno-s pranë Napoli-t, por për Torchiana-n afër Parma-s. Takimi u bâ në Torrechiara. Si Du Cange ashtu edhe J. A. Thuasne (krh. vepërën e këtij *Historiarum sui temporis* [Aurelianae 1626], faqe 259-260), gjithashtu K. Hopf-i, e vendosin në Torchiana dhe n'afërsit e Romës (Urbs në vend të urbs scil. Parma!). Drejtoris së Bibliotekës Palatine në Parma, nën udhëheqjen e dr. Maria-Teresa Danieli-t, i jam mirënjoftës për njoftimet: L. A. Muratori « *Annali d'Italia* » (Lucca 1764), faqe 216, ashtu edhe Bonaventura Angeli « *La historia della Città di Parma* » (Parma 1591), faqe 580, 582-583, pastaj Giovanbattista Adriani « *Istoria dei suoi tempi* » (Venezia 1587), faqe 537, 562.

(143) Simbas njëj lajmi qi pati mirsin të më jipte zoja Dr. M.-T. Danieli me 14 dhetuer 1954, një dorëshkrim i fundit të shekullit 18 asë i fillimit të shekullit 19, i cili përfshin mbishkrimet e të gjitha kishve të Parma-s, nuk e përmendë aspak vorrin e Arjanitit, kështu qi, mbas gjase, nuk ka qënë kurr një i tillë.

(144) Kúr A. Gegaj pohon (vepër e çekun, faqe 58) se « *de nos jours encore, on rencontre des descendants de cette famille albanaise* » e na shpjen te *La Nazione Albanese XXIII* (Romë 10-1-1919), na dishmon edhe një herë tjetër sistemin e vet pá mbështetje në trajtimin e burimevet historike. Në

faqen e parë t'atij numri t'asaj reviste gjëjmë me të vërtetë fytyrën e njëj « *Marchese Giuseppe Angelo Aurineta, ultimo discendente in linea diretta degli Arianite Comneno* » dhe pohon se ky Marchese « *oltre ad essere il solo legittimo erede e discendente dell'antichissima Imperial Casa dei Comneno, che fondò tra altro Alessio, illustrò Durazzò es annoverò tra i suoi Stati l'Epiro, la Cilicia (!) e la Macedonia* »; se ky rrjedh nga Familja e « *Comneno Arianitas, o Comneno Albania agnominata Prototipo* » (!). « *In un altro numero* » jipej fjala se do të botohej gjenealogjija e saktë e këtij Marchese të çuditshëm, për të tregue këso dore të drejtën e tij për « *discendenza legittima* ». Kjo është njëna prej shumë rasave në të cilat gadi vjet për vjet ndonji Familje qi jeton në Itali apo në Spanjë përpiqet të dishmojë të drejtën e fronit perandorak bizantin. Unë kam një grumbull botimesh me të tilla marrina. - Mâ i vjetri i këtyne ndërtrarve të historis është Giov. Andrea Angelo Flavio Comneno me librat e vet « *Genealogia Imperatorum ac Regum aliorumque Principum et illustrium Virorum... usque ad annum 1550* » (Roma 1555); « *Genealogia diversarum principum familiarum mundi...* » (Venezia 1621) ashtu edhe « *Genealogia Ioannis Andreae, cognomento Angeli sive Silvii...* » (Napoli 1603).

(145) Le të krahasohet vepra e tij « *Chroniques gréco-romanes* », faqe 535, mjerisht pa dokumentime.

(146) Të krahasohet për këtë gjâ Ch. Hopf-i, në veprën e çekun, f. 533.

(147) Ky princ serb Gjergji mund të jetë vetëm djali i parë i Gjergj Branković-it, i cili, si djali i Angjelinës Arianiti dhe i Stepan Branković-it, pat sundue si dhespot prej vjetit 1486 deri në vj. 1496 (krh. Jireček « *Geschichte der Serben* » II/1 [Gotha 1918], faqe 252 e vijanos) dhe qi pat qënë martue për një kohë të shkurtë me Izabelën, një farefis i afërm i mbretreshës Beatrice t'Aragonis, qi pat qënë ndâ nga e shoqja dhe në vjetin 1496 i a lëshoi qeverin vëllaut të vet Jovanit (1496-1502). Gjergj Branković-i vdiq me 18 kallënduer 1516 në Krusédol në Fruška Gora (Serbi).

(148) Kjo shkresë shumë e rrallë gjindet në Biblioteca Nazionale në Firenze, ku Delio Cantimori (Firenze) pati mirsin të bājë për mue një kopje fotografike, të cilën unë i a kam dhurue Bibliotekës Kombtare Marciana në Venedik, mbasi nuk gjindej n'asnjë librari botore të Venedikut.

(149) Ky Alberto Pio di Carpi ishte në marrëdhânje të mira-me Kurjen, sikursë shifet në « *Geschichte der Päpste* » të Ludwig v. Pastor III/2 (1924), ff. 743, 769, 770, 865, 904. Edhë vëllau i këtij Lionello u përzie në politikën papnore (krh, po aty, III/2, faqe 784 ashtu edhe M. Sanuto-n, XI, 336, dhe prap J. Brosch-in « *Papst Julius II. und die Gründund des Kirchenstaates* » (Gotha 1878), f. 209. J. Brosch-i boton dokumentime gjithëfarësh për historin e jetës së K. Arjanitit nën Julin e II, tue i nxjerrë këto nga akte të ndryshme venedikase (faqe 138, 332 e v.).

(150) Paolo Mastri « *Lionello Pio da Carpi in Meldola* » (1531-1571) në « *Atti e Memorie della Deputazione di Storia Patria per l'Emilia e la Romagna* » VI (Bologna 1941) shenon në radhën gjenealogjike (faqe 229) shtatë fëmij prej martesës së dytë.

(151) Kështu pohon Gius. Gerola, vepër e çekun, faqe 9, shenimi 3.

(152) Ky Erasmo përshkruhet nga M. Sanuto (III, 161) si shumë i pasun

ndërmjet pjestarvet të Familjes Trivulzi: « *Missier Rasmio di Triulzi, lo qual di roba è lo primo di quella caxa* ».


(153) Edhë këtu dishroj t'i paraqes falënderimet e mija mâ të nxehta Princit Gian-Carlo Trivulzio (Milan) ashtu edhë administratorit të tij, Z. Bruno Bonalume (Milan) qi patën mirsin të më jipshin lejën për të përdorë arkivin e bukur familjâr të kësaj Familje së përmendun milaneze (Via San Damiano 4).

(154) Mbi shërbimet qi Gjergji Konti Trivulzio i pat bâ Republikës së Shën Markut ndërmjet vjetve 1557-1565, sigurisht do të gjindeshin edhë të tjerë dokumenta në Arkivin Shtenuer t'atjeshëm. Mbasi u lirue nga detyrimet kundrejt Republikës së Venedikut, Konti Giorgio T. kthei në Milan. Pronat e tija Locate Triulzi dhe Triulzio gjindeshin n'afërsit e qytetit (6-13 km).

(155) Krah. në « *Commenorum Arianitarum Stemma* » pjesën « *Familiae augustae byzantinae* » (Paris 1680), faqe 197 e vijim.

(156) Në vjetin 1533 përmendet si « *capo delle milizie* » të Monferrato-s një farë Alvaro de Luna, qi, për shkak t'emnit mund të radhitet sigurisht në listën e Familjes së kontavet de Luna të Fuentidueña në Spanjë. Don Alvaro de Luna shifet mâ vonë (rreth vjetit 1544) si « *castellano di Milano* », në të cilën detyrë pak vjetë mâ vonë (në gjymsën e vj. 1547) pat qënë zâvend-sue nga Don Juan de Luna; si shifet, ai do të ketë pasë vdekë pak përpara.

(157) Giorgio Levi della Vida (Romë) pati mirsin të më njoftonte shenimin qi V. Forcella e kishte pasë marrë në *cod. Chigiano* (Fletë 8<sup>v</sup>). Nji gjurmim dhe shqyrtim i dorëshkrimit nxori në shesh se mbishkrimi i fundit ishte prej vjetit 1578, prâ gjashtë vjetë mbas vdekjes së Papës Piut të V (1566-1572), kështu qi ai mbishkrim nuk mund të thuhet me siguri se kâ pasë zâna-fillen e vet nën pontifikatin e tij. L. Schrader-i dihet se kâ qindrue në Romë për herën e fundit në vjetin 1567, kështu qi të dyja tekstet e mbishkrimit do të kenë qënë kopjue në të njëjtën kohë. *Adhuc sub iudice lis est.*



# «Antologia della lirica albanese»

di Giuseppe Gradilone

Gli studi di albanologia in Italia in questi ultimi anni hanno registrato una particolare fioritura: si è avuta finalmente una storia della letteratura, quella dello Schirò, ispirata a vivo senso critico e storico ed esauriente nella informazione; sono stati pubblicati studi monografici di diversa natura, di critica letteraria e di linguistica, raccolte di testi orali, sia di poesia che di prosa. Mancava sinora però un'antologia della lirica in italiano, quali nella nostra epoca sono apparse per quasi tutte le altre letterature. Chi poteva darsela se non il Koliqi, animatore di questo fervore di studi, e per la magistrale conoscenza delle due lingue e per l'indiscutibile gusto e per l'originale estro poetico? Da anni egli è andato preparando questa opera, che è veramente un gioiello nel suo genere: « **Antologia della lirica albanese** » (versioni e note a cura di Ernesto Koliqi - All'insegna del Pesce d'oro, Milano 1963 - Ed. Vanni Scheiwiller, pp. 318). Esauriente il sintetico e concettoso profilo della lirica con cui il volume si apre, dove con pochi tratti, espressione pregnante di una sicura e profonda padronanza della materia, l'Autore riesce a dare il carattere di un'opera e di un poeta. Preziosi i « cenni biografici » e le « note ai brani degli autori » con cui il libro si chiude. L'intento del lavoro? quello di dimostrare la perennità e la varietà della poesia della gente albanese espressa « nella millenaria e sempre viva lingua degli Illiri », aperta ai soffi dello spirito moderno, ma « illesa nella nobiltà della sua sostanza etnica » (cfr. p. 41).

L'antologia si divide in due sezioni: **poesia popolare**, che ha un'importantissima importanza nelle lettere albanesi, e **poesia d'arte**. In questa seconda parte il Koliqi, al di fuori di ogni sollecitazione di natura extra-artistica, ci presenta un panorama ampio ed indovinato, spaziando nell'arco di tre secoli: dal Variboba (sec. XVIII) attraverso le voci più significative del Parnaso albanese, diverse nello spirito e nella forma, fino ai rappresentanti della giovine poesia del dopoguerra, non esclusa quella del Kosmet (cioè delle provincie di Kosova e Metochia, annesse alla Jugoslavia). Fare citazioni? Dare un giudizio sulle traduzioni? Penso che in questo caso è forse inopportuno, perchè il discorso si porterebbe molto lontano e per le une, troppe venendoci a proposito, e per l'altro, dovendo affrontare il vecchio problema del tradurre. Questo soltanto dico, che il Koliqi, tenendo conto dei limiti di spazio (egli stesso si rammarica di aver dovuto, « costretto dallo spazio avaro » « omettere . . . nomi di primo piano ») è stato felice nella scelta e da poeta ha tradotto i poeti. Ed aggiungo che il libro ha già attirato l'attenzione di molti ed ha avuto apprezzamenti lusinghieri. Cito per tutti la nota di Quasimodo, il quale in forma ispirata ha cercato di dare un'idea della complessività dei motivi delle voci registrate (Cfr. « Le Ore », 5 settembre, p. 28).

L'unico consiglio che si possa dare al lettore è di prendere l'Antologia, perchè egli, man mano che si inoltrerà nella lettura, si accorgerà della presenza non trascurabile di una poesia a lui spesso sconosciuta, si spoglierà di pregiudizi e di luoghi comuni, che fanno spesso ignorare ciò che è considerato, a torto, l'espressione di popoli che non si impongono o con la forza numerica o con una schiacciante tradizione che abbaglia ed acceca. Si accorgerà che come la lingua così anche la poesia albanese germoglia da una complessa ed antica **humus** spirituale, ignota ad altre letterature, si accorgerà della delicatezza con cui essa sa esprimere gli eterni motivi dell'animo umano e si convincerà infine che la lettura non sarà stata vana.

Il Koliqi con questa fatica ha reso con documenti inconfondibili un grande servizio alla sua terra: non ha dato agli italiani le solite note di colore, di cui tanto è avido il nostro tempo e con cui spesso con strana presunzione si giudica, ma ha loro svelato la vera ed autentica anima dell'Albania, quella che la poesia con la sua forza immortale eterna nei secoli.

### Amici Lettori!

Sta per finire il VII anno della nostra rivista.

Dimostrateci la Vostra simpatia in modo concreto **inviandoci subito l'abbonamento per l'Anno 1964** (VIII anno di **Shêjzat**).

Veniteci incontro procurandoci nuovi abbonati.

Ci rivolgiamo particolarmente agli Italo-Albanesi che in **Shêjzat** hanno un chiaro specchio della loro spiritualità e delle nobili suggestive tradizioni. In terra d'esilio, la nostra rivista sulla loro simpatia soprattutto e sul loro appoggio fa affidamento.

Aiutate la rivista **Shêjzat** (Le Pleiadi) e diffondetela fra amici e conoscenti.

Inviateci il Vostro abbonamento sul **c/c postale 1/23626 - Roma**.

## Gjakmarrje në Malësi

nga Vasil D. Alarupi

Në kanapen e çardhakut të ngusht e t'errët, të Poskumandës së Gjindërmariës, qenë ndenjtur tre kryepleq katundesh të cilët kishin ardhur atë të hënë në mëngjes, ditë pazari, për të sjellë taksat e fshatarëvet. Çpalosnë me radhë nga një tok me letra zyrtare dhe njëri syresh që dinte pakëz shkrim ua lëçiti me ngadal pastaj i vendosnë përsëri gjithsecili të tijnë ndë xhepa të jelekëve dhe numuruan paret për t'u siguruar se i kishin tamam. Pas kësaj, më i riu nga të tre, u sgjati shokëvet kutin e duhanit.

— S'kanë njerzia, or miq, s'kanë... Mezi munda t'i mbledh një a dy lekë. — Filloi të thotë ay më plaku duke dredhur cigaren.

— Lere, mos e pyet hallin... — ia preu tjatri.

— Borxhet e Qeverisë duhen larë, or vëllezër, po ç'ti bësh të shkretit fukarallëk, — shtoi i treti.

Vajtje-ardhjet në Poskumandë qenë të pareshtura. Zilja e telefonit s'pushonte. Poskumandanti bërtiste me ashpërsi:

— Allo!... Alloo!... Allooo!... Ptu!... të marrtë dreqi telefonin, të marrtë!... Po ç'ka sot ky që s'punon?!... Alloooo!...

Kapteri i nxehur nga mospunimi i telefonit, mjeti i ndërlidhjes së shpejtë me Postet e tjerë të shpërndarë nëpër ato vise malësie, mjet edhe m'i vyer për çdo veprim të ngutshëm, plasi me zemrim veglëzën, vrrrojti vetullat edhe i urdhëroi sekretarit:

— Zenel, hik e m'a thirrë Tetar Ramon, të vijë shpejt!

— Si urdhëron, zoti Kapter.

Sekretari i Postkumandës, një djalosh korrozi me supe të ngushtë i cili po shkruante mbi tryezën e tija plot kartushka, braktisi punën dhe këceu mbë këmbë posi një sustë; goditi thundrat e këpucëve të tija të rënda duke marrë një qëndrim nderimi, bëri një të dredhur i krekur dhe dolli.

Me të parë Sekretarin, të tre kryepleqt u çuan dhe nderuan.

Dhe duke pritur, Kapteri zu t'ecë nëpër zyrën e ngushtë të mbushur me tryezat, kareklat e një por prej llamarine; i shkurtë e barkalec siç ishte, me sytë q'i lëshonin xixa, vetullat vrrrojtur, fytyrën të majme, kokën tullupane dhe duart në xhep të bollkavet.

Të tre kryepleqtë, gjene u-çuan më këmbë e nderuan. si më parë, kur Sekretari me Tetar Ramon u shkuan përpara.

— Ç'urdhërove, zoti Kapter? — tha Tetar Ramua duke nderuar me t'hyrë i shoqëruar nga Sekretari.

— Pa vështroje dreqin! — urdhëroi ay me fytyrë të mërzhitur duke treguar telefonin me gishtrinjt e pëllëmbës të çapluar. — S'po marr vesh gjë, e zilja s'ka pushuar së rëni tër këtë mëngjez; na nxori veshët. Kush e di se ç'ka ngjarë...

— Si urdhëron, zoti Kapter.

Ndërsa Kapteri, turrinjt varur, priste me duart prapa e bishtin e cigares ngjitur pas buzës së shtme duke rahur dyshtemenë me majën e këpucës së djathtë e duke mbyllur syrin nga të djegurit prej tymit të cigares, mekaniku specialist i telefonit të Postkumandës, nuk u vonua. Trazò këtej, trazò andej; hiq një vidhë e shtrëngò një tjtër; fry këtu e fry atje, e ndreqi: — Po, këtu është ... Merr'e... — Si foli me centralistin ia dorëzoi Kapterit, ngjatjeto dhe dolli.

— Allo!... Hë, folë... Kush je?... Ti Zef?... Si the, ore! Jo xhanëm!... Do të vinj vetë... Përpiqu mos e shtjesh në dorë... Hap sytë, Zef... Tungjatjeta.

Biseda e papritur telefonike tërhoqi vërrejtjen e Sekretarit i cili pushoi të shkruajë e duke vërtitur nëpër gishtrinjt kalemin e tij po dëgjonte me vështrimin mbërthyer në fytyrë të Postkumandantit. Nuk iu durua, pyeti:

— Ç'ka ngjarë, o zoti Kapter?

— Nuk besoj t'a dish ti, se ishe i voqël asi vafti. atë vrasësin e çmëndur, Sul Beairin, të cilin pas pesëmbëdhjet vjet burgimi e liruan njëra tri javë të shkuaara. Zefi më tha se dje, ay paska vrarë të vetëmin mashkull q'i mbetej shtëpisë së hasmëve të tij, plakun Idriz Sanin. Passi kreu krimin e shëmtuar, kuximtari mori malë. Ngjarja ka tronditur gjindjen e rrethit ku Idrizi nderohej fort, — shpjegoi Kapteri me zemrin t'hidhëruar edhe shtoi se do të nisej me një herë. Passi i dha urdhërat edhe porositë e si mori nga zyra ç'kishte nevojë, çeli derën dhe pa katundarët të cilët, me të shkuar koha, ishin shtuar e grumbulluar në çardhakun e ngusht e t'errët.

— Zenel, kujdesu ti për këta dhe mbaj shënimet e dukura. Unë mund të vonohem një dy-tri dit. Aj, tungjatjeta.

— Udha mbarë, zoti Kapter, hiç mos ki gajle. — Dhe pa humbur kohë filloi të presë kryepleqt e fshatravet.

\* \* \*

Kur u kthye Kapteri me xhandarët e tij i dorëzoi proceset Gjyqit. Për t'a shtrënguar kuximtarin të épet, Drejtësia vendosi së pari internimin e tërë familjes së Sul Beqirit në njërën nga krahinat më të largëta të Jugut dhe si kaluan disa javë gjyqi u çvillua në mungesë të vrasësit dhe e dënoi atë me vdekje.

— Të rrojnë mbi tokë kësi njerzish, o zoti Kapter, më është dukur e pabesuar. — Filloi të thotë Sekretari duke regjistruar letër-vendimin e Gjyqit që posa kishte arritur. — Unë mrekullohem me këto kodra të bukura e pjellore që janë të paprekura nga dora e këtyre njerësve të cilët jetojnë me pushkë më sup, më vënd të përveshin mëngët e të rrëmbejnë shatën për t'i çfrytëzuar e begatuar.

— Hé, hé! Zenel, je akoma i ri, ti! Ç'të të thom: disa nga zakonet e tyre prapanike nuk janë veçse shtrembërime të zakoneve që përfshihen në Kanunin e Malsis i cili është një nga monumentat më të

madhërisëm të njerzis Shqiptare. Ato shtrembërime kanë qënë krijuar nga mënyra e rreptë dhe e varfër e jetës që kanë bërë e bëjnë n'ato kënde, ku mund të kishte pasur prodhime të bollëkta dhe begati që të përbanin zakonet e vjetër themelor. Po mungesa e arsimit, mos dija e shumë gjëravet në lidhje me natyrën e acaroi jetesën, e bëri atë njerzi më t'egërt nga natyra e dëmtuar edhe nga mosdija e saj. Ka qënë një mjerim i madh për Vëndin t'onë plag e nëmur e hakmarrjes që ka çfarosur ajkën e burravet. Duhet durim se jeta e një kombi të moçëm si i yni, nuk pritet të ndryshojë brenda një kohe të shkurtë; zakonet t'ona, në jetën kombëtare më përngjajnë posi disa minuta kur vjen fjala për ndryshime. Këto kanë filluar të vijnë dal nga dal e shkallë-shkallë, me matje dhe urtësi, që të puthitem me mendimin modern të ligjit. Këcimi i pamenduar e i rrëmbyer do t'ishte si këcimi i pleshtit që s'di ku bje pasi bën këcimin. Po rreptësia e atyre zakoneve ka pasur anën e mirë se ka qënë ligj më një komb pa Shtet, pa qeveri kombëtare ndënë sundonjës që as ligjet e vetë nuk nderonin. Sot, me çvillimin e Arsimit Kombëtar, me çeljen e udhëvet, me shtimin e teknikëve dhe të shkencëtarëve t'anë do t'ecim drejt ngadhnjimit të një t'ardhmeje të çkëlqyer për këtë vënd të dashur me njerzi bujare, të sgjuar, përparimdashëse. Pa fjalë që na duhen përpjekje, dhe punë, punë, punë... Oh, do të kemi, këtu-atje, ndonjë Sul Beqir që do të shkelë ligj a zakon se, për fat të keq, njerzia e tërë nuk është shqerkë. Po, pa shiko Zenel, pa dashur të mbajta një fjalim.

— Si s'të kisha dëgjuar ndo njëherë, o zoti Kapter. — Ia preu Sekretari, i cili shtoi: — Të jam mirënjohës.

— Hiç s'ka përse, Zenel. Po tani duhet të nisen për në fshat të të dënuarit dy nga xhandarët që të vendosin atë letrë-vendimin e Gjyqit mbi portë të shtëpis së tiya. Thirë Alushin edhe Tajarin. Mos harro t'u japish edhe ato letrat që kemi për Reshter Zefin.

Sekretari nuk u përgjegj me njëherë si pas zakonit. Kapterit iu duk sikur nuk iu muar vesh urdhëri andaj i hodhi vështrimin.

— Zoti Kapter..., desha të të lutem për një gjë.

— Folë Zenel. — Përgjegjji eprori pakëz i habitur.

— A bën të vete unë në vëndin e njërit nga ata të dy? S'kam dalë veç se më të rrallë nga Zyra dhe më pëlqen t'i njoh më mirë bukurit e këtyre anëve të Vëndit t'onë.

— Po punët e Zyrës?

— Tetar Ramua mund t'i kryejë për një dy-tri dit.

— Po mirë, mor djalë, mirë. Nesër të nisi që me natë.

— Ty më të falemnderjes, shumë e shumë, o zoti Kapter.

— S'ka përse.

— Po shkoj me Alushin. Do të vete t'a lajmëroj. — U krekua, goditi thundrat e këpucëvet me hujë, nderoj ushtarakisht dhe dolli me vrap.

Kapteri i hodhi një vështrim të shpejt me buzëqeshje.

Përnjashta dita ishte e çkëlqyer me qiellin pa re. Sekretari i Postkumandës mbushi mushkëritë me ajrin e pastërt. Në degët e çinarit përkrash, zogjtë ia thoshin e tingujt e melodis së tyre përzjeheshin me notat e ëmbla të një kënge kombëtare, kënduar nga nxënësit e Shkollës poshtë bregut.

— O Alush!... — thiri Sekretari, — eja pak aty.

— Peqe, zotnis s'ate! — përgjegji xhandari plak që po kuvëndonte rehatisht me tre nga shokët e Armës, ndenjgur këmbëkryq mbi barin e blerimtë ndë hije të çinarit.

\* \* \*

Të dy xhandarët u sosnë mjaft vonë në katundin e gjakësorit. Natën e kaluan në Postën e vëndit q'ishte ndënë urdhër të Reshter Zefit dhe të nesërmet më të sbardhëllyer, të shoqëruar nga një xhandar i atjeshëm u drejtuan te shtëpia e Sul Beqirit.

Godina ishte e vjetër me dy kate, me mure të treshë dhe e veçuar. Xhandari që i shoqëroi gjer atje, pasi u tregoi shtëpinë, i ngjatjetoi dhe vashdoi udhën për në katundin ku kishte marrë urdhër të shkojë.

Sekretari nxori nga trasta letër-vendimin e Gjyqit dhe filloi t'a mbërthejë mbë drasat e vjetra të portës duke folur kundra të liqut. Dhe kur po mateshin të largohen, një zë i ashpër u bërtiti që brënda:

— Kush është te porta?

Të dy gushëkuqët u vështruan në sy të habitur dhe vetiu duart u vanë në këmbëza të pushkëvet dhe muarn qëndrim.

— Nuk duhej të kishte njeri brënda, o Alush — tha Sekretari.

— Ke të drejtë, po ç'të bëjmë?

— Hyjmë brënda, mbase fshihet gjakësori.

Alushi nuk u përgjigj me njëherë, mendonte në përqaqjësia tek-nike se ishte një xhandar i vjetër ay dhe vitet e shumtë në shërbim i kishin mësuar të jet shumë i kujdesur e gjakftohët. Andaj bërtiti me zë të lartë urdhëronjës:

— Kushdo që je ti brënda, dil dhe dorëzohu!

— Hikni q'aty, hikni!... — ishte përqaqjësia e zërit t'ashpër.

S'kishte më dyshim. Me disa të ngjeshura të forta kondakësh porta e vjetër u çkye dhe u hap. Sekretari mori sulm dhe u mat të lëshohet brënda, por Alushi fët e rroku për krahu dhe e ndali. Sa e hoqi pas tij, një pushkë krisi që brënda shtëpisë dhe plumbi u vërsëlleu në veshë. Pastaj xhandari plak, duke qitur pa pushim bëri njëra dy-tre hapa. Po një tjetër e shtënë që brënda e rëzoi për toke. Zeneli me vrap qëlloi mbi gjakësorin por ay në shteg më të volitshëm vashdoi të sbrazë pushkën dhe e plagosi në krahun e mëngjër. Dyluftimi me gjith ato, rodhi për disa minuta kur njëherësh të shtënat nga brënda pushuan. Çkyerja e një dritoreje prapa shtëpisë i tërhoqi vërejtjen Sekretarit i cili ahere u sul mbi shokun. Alushi dukej pa shpirt. Zeneli me të shpejtë e me kujdes i ardhni rotull shtëpisë dhe kuptoi se i liq kishte hikur. Pa humbur kohë më shumë, rendi të lajmërojë Reshterin.

Me të parë Sekretarin të gjakosur dhe thëllërisht të tronditur. Zefi vrapoi kundrejt tij. Shtrëngoi dhëmbët e pëllëmbët e lotet mend i binin nga hidhërimi kur mësoi të najarën. Si e miekoi edhe i lidhi krahun Zenelit, me ata pak xhandarë që kishte edhe me disa vullnetarë të fshatit shpejtuan te shtëpia e vrasësit.

Të gjithë burrat lëshuan një klithmë gëzimi edhe thirrë pothuaj njëzëri kur panë Alushin, vërtet të gjakosur. po me pushkën në dorë e që priste atje sipër, bri udhës, që shpinte në mal.

Plumbi i gjakësorit i pat marrë vetëm lehtazi çipin e ballit. Një çun i vogël tregoi se kishte parë vrasësin me pushkë në dorë të marrë

të përpjetën, duke rendur si një i çmëndur, i pa rrojtur e i paqethur, me sytë të sgurdulluar. U shpërndanë katër nga katër me urdhërin e prerë të Reshterit t'a kapin kriminelin të gjallë a të vdekur.

\* \* \*

Dielli ishte më të perënduar. Të gjithë qenë të lodhur e të zemruar nga kërkimi i kottë. Reshter Zefi me Alushin, xhandarët e tij edhe shumicën e fshatarëve vullnetarë po uleshin për në katund, kur një e krisur pushke u tërhoqi kujdesjen. Qëndruan përkëtej një prroj dhe hodhë vështrimin më të katër anët. Mbi një shesh të vogël, rëzë një shkëmbi të lartë që dallonte atë çast ndënë rezet e fundmë të diellit, panë Sekretarin me krahun lidhur e tre nga katundarët që kishin qëndruar atje. U bënë zë dhe vrapuan drejt tyre.

— Zoti Reshter!... Zoti Reshter!... — bërtiti Sekretari kur iu afrua toga. — Një bishë ia mori hakën bishës!

— Cili është i vrari e ç'qënka më këtë ditë?!... — pyeti me ngutësi Reshter Zefi.

— Gjakësori, Sul Beqiri! — thanë njëzëri Sekretari dhe fshatarët q'e shoqëruan në ndjekjen.

— Pu-pu, orel!... — ia bënin të gjithë me fytyrat si të tmeruara nga ajo pamje.

— Zoti Reshter dhe ju o miq, dëgjoni, dëgjoni se ç'na panë sytë. — filloi të tregojë Zeneli: — Tek kërkoni për të rënë në gjurmat e të liqut, duallm afër këtij shkëmbi dhe mbetmë të habitur kur pamë aty mbi shesh, gjakësorin ndenjor mbi këtë gur. Ndër këmbë kishte një klysh ariu që pat vrarë. Ndërsa po mateshim të shtjemë mbi kriminelin, u çvillua para syvet t'anë një luftë ndërmjet kafshës së pyllit dhe bishës njerzore. Një arushë e madhe e murme, u çfaq përmbi shkëmbin dhe filloi të vërrejë reth e përqark. Me të parë gjakësorin, lëshoi një klithmë aq të fortë sa gjëmoi mali. Ishte e egërsuar në kulm. Gjakësori e pa dhe u tmerua por në një kohë sikur e mblodhi vehten e u gëzua për luftën e hapur q'i bënte arusha. Ne qëndronim të tulli-tur dhe pas urdhërit që dhashë me zë t'unjtër, asnjëri nga ne s'piktinte, vetëm vështronim të habitur sqenën që po çvillohej përpara syvet t'anë. Sul Beqiri kapi pushkën dhe filloi t'a mbushë. N'at çast arusha lëshoi të tjera klithma t'egra. Më dukej sikur ishin dhembjet çjerrëse që dilnin nga zemra e saja e lënduar për foshnjën q'i kishte vrarë i ligu. U uni me të shpejtë dhe me tapanxhën e mëngjër rrëmbeu një gur. Pastaj u ngrit mbi të dy këmbët e prapsme, këtheu kurrizë dhe me një fuqi të madhe e një synim të çudimë flaku qurin në drejtim të kriminelit. Aq s'pati kohë të ngrerë sytë nga llozi i pushkës se guri i arushës e goditi mu në zemër dhe e shtriu për toke sa i gjati qe. Pushka i shkau. nga duart, ra disa hapa më tej edhe u sbraz. Ahere arusha u lëshua drejt armikut. Kapi me tapanxhat e saja qurin, mbi të cilin cazë më parë i ligu ishte ndenjor, u ngrit mbi këmbët e prapsme, synoi mbi kokën e tij e më t'ia përplasi furrishëm. Asnjë rënkim nuk doli nga gjoksi i proinës së saja, veçse zërit të shurdhër dhe të llahtarshëm të koskavet që bëhen bërlok nga silla edhe pesha e gurit. Kafsha i hodhi akoma një vështrim plot urrejaje, që na habiti të gjithëvet, rrëmbeu ndër dhëmbë klyshin e vetë dhe hiku përpjetë malit».

# Legjenda

nga Martin Camaj

## Liçeni i Prevezës

Në liqë të vjetër të Prevezës  
përpiqen dielli e hana  
mbramjeve verore n'ujë.  
Ai bashkim i rrezeve,  
dashnija e dy palë duerve  
me gishta të kapërthjem,  
â çmallimi i peshqve  
në mâ të shkëlqyeshmîn shtrat:  
— hana rrin e dielli shkon.  
Në liqë të vjetër të Prevezës  
këqyren shkambijt e kuq,  
kodrave âsht dheu si ari,  
nalt janë malet e thata  
janë rrafshet me bar pak  
të lodhuna prej shatorreve  
dhe ushtrive me heshta.  
Preveza âsht kal i egër  
edhe shkundi prej vitheve  
kshtjelle e qytete  
e tash pushon nën hanë.  
Preveza grue e gjanë pjellake,  
Preveza grue lehonë.  
Tash e shkllasin njerzit e vorfën  
me kambë të zbathuna verës,  
me kambë të mbathuna keq  
në heshtje si hajna  
që mos të zgjojnë pronarët e motit  
fjetun nën gur si gjarprij.  
Në breg të liqënît përtpjetë  
kapeshtin dikur banesat,  
rrashta kaçamijsht ndër curra.  
(Në këtë natë tue i këqyrë  
më shtâhen dritat e vjetra shpatit  
e në skâj të djathtë mbi koçek  
tre qira në shalldana,  
para tyne tue punue Balë Mjeshtri  
kujunxhi argjandesh së përmenduna

gërmuç mbi tryez.  
 Në terr mbas shpine flen nusja  
 e zbulueme deri në brez,  
 nusja me gji të bardhë  
 si dy molla shpatash  
 si ato shpatat në kuja  
 tash sa të gëdhenduna për trima.  
 Në votër zjarmi shkrin  
 argjandin ndër vorbulla.  
 Ftyra e mjeshtrit e mprehun  
 është thithë prej vepravet  
 e drita e synit tash e ndjek  
 fillin e argjandit të hollë, të hollë,  
 anavet të palarës.  
 Syt janë dy maje gjylpanash  
 e udhetojnë për fijet e gjata  
 nëpër telat e argjandit  
 që ndeshen e kapërthehen  
 shlirohen e nisen  
 përkulen e thehen  
 te syni i gjarpnit  
 te bishti i gjarpnit  
 rreth lulesh e rreth lajlesh  
 e ngjiten e zbresin  
 neper trajat e zogjve të panjoftun  
 kacafyten ndër vedi  
 si mendimet në tru  
 në trunin e Balës:  
 «A është e lodhun grueja?  
 s' është e lodhun grueja  
 prej përgdheljes seme,  
 prej zjarmit t'argjandit  
 prej hekuravet shkullojë.  
 Grueja s' shkrihet si argjandi  
 ndër vorbullat e hinit,  
 ajo është nda prej meje,  
 grueja ka dalun shpijet  
 bregut të Liqenit,  
 bregut të Liqenit pa zjarm,  
 ke valat buzvet t'ujit  
 ke lëmashku i freskët  
 shetit grueja veshun bardh  
 me petk deri në zall.  
 Bujari me mantel të kuq  
 erdh e e muer me barkë.  
 Nusja eme sonambull?  
 Nusja eme gjarpën në gji?  
 Nusja eme ujë i gjallë  
 në themel të plangut  
 Syni im më rren?»

E suell kryet me pa gruen,  
 e s'ishte në shtrat por në lundër  
 e mbi krye nuk kishte  
 kaptellin prej drunit,  
 por bujarin me rremba  
 nji gafarre përbindëshe  
 tue rrembue nëpër ujë.  
 Atbotë mjeshtri ndieu  
 në zgurë të gjoksit thekshëm  
 etjen e sermit në vorbull:  
 u çue kadalë maje gishtavet,  
 muer nusen para duersh  
 muer nusen e duel  
 e shkoi e hypi në shkamb,  
 maje shkrepit mbi Liqë.  
 Maje shkrepit mbi Liqë  
 në pak dhé mes gurve  
 rritet lulja e hummeravet.  
 Atë mjeshtri në terr  
 me gjith nuse para duersh  
 tue kcyë poshtë e shkeli  
 edhe fletzat ia shkimbi.  
 N'ujë mjeshtri u bâ peshk,  
 por kur ra në fund  
 preku lëmashkun e butë  
 si lëkura e oqiçit në shtrat  
 e vrik u shndrrue n'argjand,  
 në nji peshk argjandi të punuem.  
 N'ujë nusja u bâ mjellme  
 me sy si uji i Liqenit,  
 me krahë të murrmë e të gjanë,  
 por erdh agimi me diell  
 e zbardhi puplat e zogut  
 mbi tallazet e Prespës.

### Beka i Verbët

Fryni era mbas malit  
 e rrxoi sanat livadheve.  
 Prej vargut të maleve  
 ulej dimni tue u ngrahë  
 tubave ndër karpa  
 — buzëve lumi në strehërë  
 atje në gjithet e shkambit —  
 ku është krandi .bulmadh  
 që pret diellin e bâhet gjeth.  
 Lari, bushi drû-mirë  
 dhe dullija e blerë  
 tretshin erën npër çuba

npër çuba e lisa të thatë,  
sy të malluem për verë  
me i gëzue një grimë  
lari, bushi dhe dullija,  
si bajrakë mes ushtrijs,  
si nuse ndër plaka.

Terri i natës vinte  
dhe qetsija npër qeta;  
uji i lumit ushtonte  
si burra në kuvend te votra.  
Pranë votre u mblodhen  
shum barë të vjetër  
të djegun në diell e borë:  
kishin pa bjeshkë  
me kullota gjithku ishin.  
Kamba u shkeli për çdo shtek  
e fortë si cung frashnit.  
Çikave u lakmuen,  
lugajet i gëzuen me kangë,  
shpend mali para verës.  
Shum ujq ata mbyten,  
gjah të madh po vranë,  
Tuba nën rojen e tyne  
si gjeth mali u shtue.

Shyt Ripën merrshin vesht,  
Shyt Ripa flitte bukur:  
«Tana kangët që na këndojmë  
Beka i Verbët i ka qitë  
kur kthei prej së largu  
mal në mal tue ecë.  
Punën e Bekës ndigjonje!  
Njizet vjezt pa i mbushë,  
mirë shtat kish lëshue  
edhe flitte búrras  
me zâ të kthiellë, ujë kroni.  
Ndër bjeshkë kur këndonte,  
në Bjeshkë të Nemuna mes tubës,  
zânin ia merrshin shpatijet  
dhe ia tretshin lúgjeve:  
merrte bari një hije të lehtë,  
merrte toka një hije të butë  
e shkrepat lëshojshin dritë.  
Thoshin vashat «i këndoftë zemra!»  
Kish Beka një fyell tisi,  
tisi birue në shkullojë:  
njeri si ai s'i binte,  
binte fyelli si zog mali,

nga njiherë si prroni ndër gur,  
si shiu mbi gjeth,  
si gojë njeriu mandej,  
e fryma fshânte npër të  
si prej zemre së ngashrueme,  
zemër npër gishtat e njeriut.  
Në bjeshkë të Nemuna erdh vjeshta  
uleshin tubat varg e varg  
e blegtorët me rraqe  
me dimnue në Rrash të Dukagjinit,  
atje te shpija e vendit.  
Shtiqet në fushë me dushk,  
lisat në bjeshkë me efull,  
dhe duvaku i bardhë  
në krye të vashave ndër troje,  
ndër troje mbushun me gjâ.

Kur gjimoi Drini i ajun  
erdh një natë e zezë,  
nji ushtri e huej si breshën  
dhe e muer Bekën me vehte,  
Bekën e dyqind tjerë  
lidhun ndër vishkulla.  
Ndër vishkulla e konopë  
i ulne bregut të Drinit  
e i qitën në det të ngjelm  
dhe i tretën n'Arabi  
me i djegun dheu i zjarmit,  
dielli i flakët fëtyrën,  
uji i brrakave me i çartë.

Kur kaluen shum vjet  
Bekës me mjekërr të zezë  
iu prish zâni në fyt  
si lahutës së plasun  
dhe ndër sy iu fik drita,  
iu fik drita dhe gëzimî,  
gjeth i veshkun në skullâ,  
ujë amull në prrue,  
u bâ gur e u bâ drû  
e mbet hije mbi ranë.  
Stina e verës në Rrash,  
kërset vada në ara,  
kur vlladi shetit hijeve  
e pemishteve të mëdhâ:  
ushtojnë bletët nalt e poshtë,  
shumohen ndër zgjoje e lëshojnë,  
prej zgjojeve në rrasa  
mjalta kullon në vapë.

Në Bjeshkë të Nemuna barija,  
Në Bjeshkë të Nemuna mbrendë në qiell,  
ku bjen bora në gusht,  
ku delet kullosin me mija,  
Il Ministro Beratti, a sua volta, ha rievocato, da par suo, in romeno, la Bucarest

di una volta: dei tempi felici della libertà, dell'abbondanza, dell'euforia e dell'amicizia. Ne è venuto fuori un grazioso affresco, pieno di colore e movimento, che ha impressionato vivamente l'uditorio.

Anche la dotta conferenza del grande glottologo Giuliano Bonfante, dell'Università di Torino, sul « Neutro in romeno e in albanese », ha dato occasione ai due ospiti sopraindicati di apportare qualche precisazione ed integrazione per quel che riguarda la lingua albanese e i suoi dialetti. Si è insistito, com'era naturale, sul comune sostrato traco-illirico del romeno e dello albanese, senza per altro esaurire in questa unica spiegazione il problema, molto più complesso, delle innegabili affinità linguistiche fra i due popoli.

Il programma del VII congresso internazionale di studi della Società Accademica Romena preannunciava una cinquantina di conferenze e comunicazioni. Di queste, sono state presentate effettivamente dai loro autori circa trenta. Le altre, brevemente riassunte in ogni seduta, verranno pubblicate negli « Acta », che la Società Accademica periodicamente pubblica. Onde non dare un lungo elenco di nomi di studiosi e titoli di conferenze, diremo soltanto che il tema centrale dell'incontro — originalità e imitazione nella cultura — è stato sviscerato in quasi ogni ramo dello scibile: dalla storia alla linguistica, dal folklore all'economia, dalla religione alla mitologia, dalla politica alla letteratura e all'artè. Fra gli intervenuti nel dibattito, ricorderemo appena i nomi dello storico delle religioni e romanziere Mircea Eliade, del poeta e romanziere Vintila Horia, premio Goncourt, dell'archeologo Dinu Adamesteanu, del critico e romanziere Marcello Camillucci, romanista di alta classe, del teologo George Racoveanu, direttore del giornale « Cuvântul în exil », dell'economista Nicolae Crisan, del saggista George Uscatescu, di padre Alexandru Mircea, che ha diretto per anni la bella rivista « Perspective crestine », di Monsignor Octavian Bârlea, l'instancabile presidente e animatore della Società Accademica Romena. As-

sai nutrita, la partecipazione al congresso dei professori di lingua e letteratura romena nelle Università dell'Italia e della Germania.

Va ricordato altresì che l'incontro si è aperto con una solenne cerimonia, nel corso della quale gli ospiti romeni e non romeni sono stati calorosamente salutati dal Vescovo locale, che ha parlato a nome di Sua Eminenza il Cardinale Alfrink, dal Magnifico Rettore dell'Università e dal sindaco di Nijmegen. Quest'ultimo si è detto lieto di poter accogliere nella sua città libera i rappresentanti della cultura di un popolo oppresso. Rispondendo alle autorità olandesi, il presidente della Società Accademica Romena ha ringraziato per la cordiale accoglienza, sottolineando quindi una significativa coincidenza: il ricordo in un monumento di Nijmegen dell'imperatore Traiano e cioè dell'**optimus princeps**, che il popolo romeno considera il padre della nazione.

Una solenne Messa è stata celebrata domenica mattina, 8 settembre, dai sacerdoti romeni presenti al congresso, nella Chiesa di San Giuseppe. Il rito orientale, con le risposte cantate da un coro impeccabilmente istruito, ha impressionato profondamente i numerosissimi fedeli, la maggior parte dei quali ascoltava per la prima volta una funzione cattolica non in lingua latina. In presenza del Vescovo, un predicatore ha spiegato ai fedeli il significato della Messa in lingua romena, ricordando la tragedia che vive oggi il popolo romeno e illustrando l'importanza del congresso di studi in corso a Nijmegen.

Sempre nel quadro del VII congresso internazionale della Società Accademica Romena hanno avuto luogo un concerto e una mostra di pittura. Al primo ha dato il suo preziosissimo concorso il basso Aurelian Neagu, dell'Opera di Düsseldorf, che ha cantato pezzi d'opera e canti popolari romeni, riscuotendo un grande successo. Lo stesso artista, insieme al compositore Nello Manzatti, che aveva aperto i lavori del congresso con una limpida conferenza su « La musica romena », hanno regalato ai

connazionali e agli ospiti una indimenticabile « serata romena » nell'albergo, dove la maggior parte dei congressisti si trovava alloggiata. I canti popolari romeni e le romanze famosissime di Manzatti hanno riscaldato e commosso tutti i presenti, che hanno tributato ai due artisti una manifestazione di calda simpatia.

Alla mostra hanno esposto tre dei migliori artisti dell'esilio romeno: la signora Nina Batalli, di Roma, e i maestri Eugen Dragutescu, di Roma, e Dimitrie Berea, di Parigi. Le loro opere sono state ammirate, oltre che dai congressisti, da critici e visitatori olandesi, che hanno avuto modo di sottolineare la forte personalità e la grande perizia tecnica dei tre pittori.

In margine al congresso, si sono avute anche alcune gite: ai giganteschi lavori di imbrigliamento del mare, al museo Van Gogh, all'Aja, a Utrecht, a Delft, a Rotterdam. L'Università di Nijmegen ha offerto un ricevimento in onore dei congressisti, che hanno visitato i nuovi locali dell'Ateneo cattolico.

I lavori del convegno, durato una settimana, dal 6 al 12 settembre scorsi, si sono svolti in un'atmosfera di serena cordialità e di reciproco interesse. Nuove amicizie si sono legate, le amicizie vecchie si sono cementate, sono stati presi accordi per più intensi contatti, in attesa dell'VIII congresso, che dovrebbe aver luogo, nell'autunno del 1964, in Ispagna, possibilmente a Salamanca (semprechè, s'intende, non fosse arrivato il momento di tenere quest'ottavo incontro nella sua sede più naturale, che è Bucarest).

Separandosi, al termine delle sedute, i sessanta congressisti hanno avuto la precisa sensazione di essersi arricchiti spiritualmente: di aver imparato molto, e in primo luogo che le ragioni di una cultura libera, non sottoposta ad un regime politico o allo Stato, vanno difese con ogni energia e in ogni circostanza. Perché un popolo perde se stesso nel momento in cui perde la libertà di creare secondo il proprio genio e secondo le sue tradizioni incontaminate.

**MIRCEA POPESCU**

## **I dyti Takim romak i kulturës.**

Shoqata me emën « Qandërr jete italjane » sivjet e përsëriti takimin ndër-kombtar kulture qi vjet pat sukses aq të kënaqëshëm. Vjet ligjirata e dendun jo vetëm me përvojë kulturore por edhe me humanitet të thellë e me urti e filozofit Gabriel Marcel qe boshti i diskutimeve ndër-tuese zhvillue gjatë takimit të parë (11-12-13-14 maj 1962). Thema ishte: *Kriza e sotshëme në letra, n'arte e në shkenca*. Studjuesa të mbarë botës sollen ndihmën e pre-gatitjes së tyne në rrahje të çashtjeve. Ishin të përfaqsuem edhe letrarët e mërguem të popujve të Jug-lindjes europjane ndër të cilët mbajten fjalë romunët e shquem Vintila Horia dhe Gjergj Uscatescu, shqiptari Ernest Koliqi.

Sivjet me 27-28-29-30 shtatuer u zhvilluen seancat e Takimit të dytë, i cili kishte për themë të përgjithëshme: *Originalitet kombtar dhe universalitet në mendimin prendimuer*. Fjalën kryesore e mbajti romanxjeri zâ-madh John Dos Passos. Pjesëmarrsit vijshin nga të gjitha anat e botës. Sidomos Francezët e Germanët, në shumicën e tyne auktorë të rij, kishin ngarendë me nji numër të shënueshëm përfaqësuesash, të cilët u dhanë mbledhjevet nji lëvizje të jashtzakonshme me guxim e shkelqim mendimesh dhe gjallëni ndërhyjmesh. Ndër spanjollë spikatte filozofi i njoftun prof. Adolfo Muñoz Alonso. Shtetet e Bashkueme t'Amerikës ishin pranë me nji tubë shkrimtarësh e dijetarësh qi tërhoqën admirimin e mbledhjeve me fuqin e mendimeve të tyne të reja. Austriakë, Belgjianë, Grekë, Portugezë mbajtën referata t'interesantëshme tue vû në spikamë vlerat e traditave kombtare të tyne në përpjekje harmonizuese me frymën e gjithmbarëshme (universale).

Natyrisht nuk mungoi zâni i mendimtarvet italkanë gjatë bisedimeve.

Prof. N. F. Cimmino e dr. Giano Accame, organizuesat dhe mbarështruesat e Takimit, me fjalimet e tyre caktoen vijën kryesore mbi të cilën erdhën tue u zhvillue punimet me referata e kumtime të ndryshme. Të shumtë qenë studjuesat italianë qi u ternuen në katedrën të folësavet: na po përmendim vetëm një, prof. Marino Gentile, filozof i Universitetit të Padova-s.

Takimi i dytë rromak i kulturës mbajti mbledhjet e veta në Theatrin dei Servi (Via del Mortaro, afër Largo Chigi) në një salë jo fort të madhe por shumë të bukur dhe të stolisur me shije të rrallë. Organizimi qe i përsosun. Fjalimet, sejcili ndëgjues me anë aparatash për t'u vù ke veshët, mujte t'i merrte italisht, frengisht, germanisht, anglisht, spanjolle aty për aty d.m.th. sa ishte tue folë ligjiruesi. Të shtatuen me 28 shtatuer në Restorantin e famshëm « Cisterna » në Trastevere má shumë se dyqind kongresista u tubuen në një darkë të zgjedhun e kaluen disa orë të kënaqëshme në shoqni të përzemërt.



## Lajme Shqipnije

(Marrë nga Radjo-Tirana)

### Kangëtarë shqiptarë në Kinë.

Tiranë, 3 maj 1963

Në bazë të marrveshjes mbi bashkupimin kulturor midis Kinës dhe Shqipris për vitin 1963, sod në Peking arriti një grup kangëtarësh Shqiptarë. Sod arriti gjithashtu në Peking për një vizitë miqsore dhe për bisedime lidhur me shkëmbimin e librave dhe botimeve periodike Drejtori i Ndërmarrjes shtetore të Botimevet të R.P. të Shqipris *Drago Siliqi*.

Tiranë, 10 maj 1963

Kangëtarët shqiptarë që gjenden në R.P. të Kinës për vizitë u duertrokitën sonte nxehtësisht në koncertin e tyre të parë në Pekin. Ishte i pranishëm edhe kryetari i komitetit të përherëshëm të Asambés Kombëtare Popullore të Kinës Ohu Te. Solot e kënduar nga Tellingu, Mentor Xhemali, tenori Maliq Heri dhe baritoni Ramiz Kovaqi dhe kuartetet vokale u duertrokitën nxehtësisht. Në mes të pranishmëve ishin edhe Chu Tu Nan, Cao In dhe Chu Bu nënkryetarët e Komisionit për Lidhjet Kulturale me vendet e hueja, Hsia Jen Nënministri i Kulturës, Tsen Yung Ch'uan Nënministri i Jashtëm dhe muzikanta të shquar të Pekinit.

Tiranë, 13 maj 1963

Sot udhëheqsi i filarmonisë qendrore të R.P. të Kinës Li Lin, botoi në gazetën *Jen Mihn Jih Pao* një artikull ku vlerësohet lart interpretimi i mrekullueshëm i kangëtarve shqiptarë. Vetija má e kpartë karakteristike e koncertit të kangëtarve shqiptarë, shkruan Li Lin, ásht plot heroizëm dhe gëzim për jetën, ata tranzmetojnë me gjallri dhe në mënyrë të thellë patosin revolucionar të luftëtarve trima. Li Lin thekson se me eksperjencën e tyre artistike, shërbimin ndaj çeshtjes së revolucionit, artistët shqiptarë u tregojnë një shembull punojsve kinezë të muzikës. Kangëtarët shqiptarë interpretuan për mrekulli kangët popullore shqiptare, ata ekzekutuan gjithashtu me sukses arje nga opera të njohura të klasikve botnorë. Li Lin tregoi gjithashtu veçuritë individuale të 4 kangëtarve shqiptarë. Si pas fjalve të tij Mentor *Xhemali* dallohet nga patosi dhe përzemërsija, Ysen *Telinku* nga shija e hollë dhe guximi, Ramiz *Kovaqi* zotron një mjeshtri të hollë virtuozi, ndërsa Maliq *Heri* ka një zë të pastërt e të butë. Në fund Li Lin

u uroi artistëve shqiptarë suksese në koncertet e tyre nëpër Kinë.

Shënim i Redaksis. — *Na gëzohemi për çdo veprimtari qi i shërben naltësimi t'emnit shqiptar në botë. E mira, kur është vërtetë e mirë, duhet pranue prej kahdo qi të vijë. Prandej përgzohemi me artistat shqiptarë, për korrje suksesesh në Lindjen e Largët. Na gicilon sedrën kombtare edhe levdata qi Li Lin u drejton si muzikës popullore t'onë ashtu interpretuesvet të saj. Nji pikë e ndiejmë veten të detyruem me ndreqë në shkrim të muzikologut kinez: heroizmi i Bijvet të Shqipes nuk lindi në luftat revolucionare të fundit por e ka zanafillën e vet në lashtësin më të shtjme, shum shekuj më përpara se të çpikkej ideologjija qi bashkon Drejtuesat e sotshëm të Shqipnis me ata të Kinës.*



### **Bibliotekat në Shqipni.**

*Tiranë, 16 maj 1963*

Të gjitha bibliotekat kanë një fond librash prej 1.050.000 volume si dhe afro 37.000 antarë. Vetëm fondi albanologjik dhe balkanologjik i bibliotekës kombëtare përbahet nga më se 22.000 volume. Fondi i librave i bibliotekës sonë kombëtare është më i madh nga fondi qi kanë së bashku bibliotekat nacionale në Etiopë, Iran, Ekuador, Kostarika, Ceylon, Kambogja, Boliví, Afganistan dhe Paraguai.

Pranë shtëpive dhe vatrave të kulturës në fshatra fondi i librave është 455.000, libra të ndryshëm, dhe 102.705 antarë. Në të ardhmen numri i bibliotekave dhe fondi i librave do të rriten akoma më shumë.



### **Pregatiten fjalorë terminologjikë.**

*Tiranë, 18 qershuer 1963*

Caktimi i një terminologjije egzakte dhe unike për sektorë të ndryshëm të ekonomisë është një nga detyrat e rëndësishme të Institutit të Historisë dhe të gjuhës të Universitetit shtetror të Tiranës. Instituti i Historisë të gjuhës pranë Universitetit shtetror të Tiranës po punon për pregaditjen e fjalorëve terminologjikë për sektorë të ndryshëm. Janë pregaditur dhe janë në shtyp 10 fjalorë terminologjikë për botanikën, matematikën, mekanikën, elektromanjetizmin, elektroteknikën, termodinamikën, akustikën, optikën, energjin atomike dhe kimin. Të gjithë këta fjalorë përfshijn 14.000 terma. Tre fjalorë të tjerë: ay i gjeologjis, i arkitekturës dhe i minieravet me 4.500 terma kanë përfunduar dhe janë dhënë për shtyp në kohë të fundit. Të gjithë këta fjalorë janë pregaditur në tri gjuhë: shqip, rusisht dhe frengisht. Janë në përpunim e sipër fjalori terminologjik i hidraulikës në katër gjuhë dhe fjalori i gjuhës në gjashtë gjuhë. Në përpunim e fjalorëve përveç punonjëse shkencorë dhe pedagogëve të Universitetit shtetror të Tiranës, kanë dhënë një ndihmë të mirë dhe shumë punonjës të sektorëve të ndryshëm. Parashikohet qi në të ardhshmen të pregaditen fjalorë terminologjikë të ilustruar dhe me shpjegime.



### **Lidhje me botën e jashtëme.**

*Tiranë, 11 korrik 1963*

Biblioteka shkencore e Universitetit tregon kujdes të veçantë për lidhje me botën e jashtëme. Tani ajo ka rreth 600 adresa universitetesh, bibliotekash dhe personalitetesh të ndryshme të të gjitha kontinenteve të botës, me të

cilat mban lidhje të rregullta duke u dërguar buletin e Universitetit dhe literaturë tjetër tekniko-shkencore, qi botohet në vendin tonë, dhe duke marrë prej tyre botime tekniko-shkencore qi u interesojn studentave, pedagogve dhe kuadrove tekniko-shkencore të vendit tonë. Gjithashtu lidhje të mira mban biblioteka shkencore e Universitetit me albanologët e vendeve të ndryshme qi merren me studimin e gjuhës, historisë, etnografisë, gjeografisë dhe folklorit të vendit tonë, duke u dërguar të gjitha materialet e nevojshme për kryrjen me sukses të studimeve të tyre. Interesim të veçantë për sigurimin e materialeve nga vendi i ynë tregojn edhe Arbreshët, të cilët bënë çmos për të rrujtur gjuhën dhe zakonet e vendit tonë. Biblioteka krahas botimeve në gjuhë shqipe ka edhe qindra botime në gjuhët kryesore të botës. Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 1963 ajo siguroi nga jashtë rreth 1000 vëllime librash të ndryshme.

### Zhdukja e poetit Drago Siliqi.

Tiranë, 15 korrik 1963

Me 13 korrik duke udhëtuar nga *Pekini* për në atdhë, në një katastrofë ajrore qi i ndodhi aeroplanit sovjetik TU 104, në afërsi të Eirkutskut, humbën jetën poeti *Drago Siliqi*, gazetari *Xhafer Baklamaja* me të shoqen dhe një fëmijë, dhe e shoqja e ambasadorit të R.P.Sh. në R.P.Sh. *Reiz Malile* bashkë me dy femijët.

Shënim i Redaksis. — *Letrësija e ré shqiptare*, e cila s'ka kufij ideologjikë por vlera artistike dhe estetike, pëson një humbje të shënueshme me *Drago Siliqin*. Poeti-orzi lindi në Tiranë me 1930 nga një familje shkodrane. Bani n'atdhë shoollat fillore e të

mesme dhe studimet më të nalta n'Institutin e letrësis Gorki në Moskë. Në kryeqytet të Bashkimit Sovjetik Dragoja qindroi pesë vjet tue i hÿ në themel njoftjes së gjuhës dhe të letrësis ruse. Këthye n'atdhë, i u vÿ me zëll punës tue qitë vjerrsha, tue rrahë probleme kulturore në shkrime plot matuni, tue sjellë në shqipe vepra të njoftuna nga rusishtja. Vjerrshat e tija spikasin për ndjekje trajtash tradicionale vargënimi të përdoruna me zotsi e me shije. Ishte Drejtuer i Ndërmarrjes Shtetnore të Botimeve.

### Kangë e valle shqiptare në Marok.

Tiranë, 19 korrik 1963

Me 13 korrik Ansambli i ynë shtetror i kangëve dhe i valleve popullore dha koncertin e tij të parë në qytetin Mecnes të Marokut, ku është duke u zhvilluar tani Festivali i III artistik i vendeve të Mesdheut. Në koncertin e artistave tonë, qi u dha në sallën e theatrit veror të qytetit, merrnin pjesë Guvernatori i Mecnes, princi Ben Dris, autoritete të tjera të qytetit dhe 700 spektatorë. Të pranishmit pëlqyen sidomos kangët popullore, disa prej të cilave kanë ngjashmëri me kangët e vjetra marokene dhe duratrokitën shpesh herë vallëtarët tonë.

### Tekste shkollore.

Tiranë, 20 korrik 1963

Sivjet është duke u bërë një punë e mirë për përgatitjen e teksteve shkollorë. Ndërsa në vitin shkollor 1962-1963 u botuan 79 lloj tekstesh me 1.200.000 kopje, gjatë këtij viti janë duke u botuar 129 lloje me 2.200.000 kopje, të cilat janë të mjaftueshme

për të gjithë nxënësit e kategorive të ndryshme të shkollave. Gjer tani kanë dalë nga shtypi 94 lloj tekstesh, deri në fillim të gushtit do të dalin edhe 6 të tjerë. Kujdes i veçantë është treguar për tekstet që do të përdoren për shkollën e riorganizuar.



## Shtohet popullsija shqiptare.

Tiranë, 30 korrik 1963

Me përmirësimin e vazhduem të kushteve materiale popullsija e vendit tonë po rritet nga viti në vit me ritme të shpejta. Si mbas të dhënave të Drejtorisë së statistikës pranë Komisionit të Planit të Shtetit gjat vitit 1962 për çdo 1000 banorë pati 39,3 lindje dhe vetëm 10,7 vdekje. Në këtë mënyrë me rritjen e lindjeve dhe paksimin e vdekjeve popullsija e jonë u shtua gjat vitit të kaluar me 28,6 vetë për çdo 1000 banorë. Si përfundim me sa me 1938 lindi 195 veta për çdo 100 të vdekur, me 1950 274, me 1962 366, raport ky më i larti se në çdo shtet tjetër të Evropës. Me një rritje të tillë popullsija e përgjithëshme e Shqiprisë në fund të vitit 1962 arriti në 1.736.000 frymë. Gjat tremujorit të parë të këtij viti, si mbas të dhënave paraprake, lindjet kanë qënë edhe më të larta, popullsija u shtua me 43.000 frymë, ndërsa vdekjet u ulën 16,7% në krahasim me tremujorin e parë të vitit kaluar. Me industrializimin e vendit mjaft është duke u rritur edhe popullsija qytetare. Kështu me sa me 1938 popullsija qytetare përbante vetëm 15,4% të popullsisë së përgjithëshme, në fund të 1962 arriti në 32,5%.

## Delegacion kulturuer n'Amsterdam.

Tiranë, 20 gusht 1963

Sot u nis për në Hollandë një delegacion i kryesuar nga *Androkli Kostallari*, Drejtori i Institut të Historisë dhe Gjuhësisë për të marrë pjesë në Kongresin e VIII të Onomastikës që do të mbahet në Amsterdam prej 27 deri 31 gusht, dhe në Kuvendin e IV ndërkombëtar të linguistëve që do të mbahet në Milano prej 2 deri me 6 shtator.

---

Shënim i Redaksis. — *N'Amsterdam e në Milan bashkë me Androkli Kostallarin mori pjesë në kongreset gjuhësore të mbajtura n'ato qytete edhe linguisti shqiptar prof. Ekrem Çabej, i cili për të parën herë ka dalun përjashta nga Shqipëria ç'prej sosjes së luftës.*



## Kultura kineze në Shqipëri.

Tiranë, 3 shtatuer 1963

Sot u larguan nga Shqipëria kandidatit i shkencave kimike *Cic Zen U* dhe kandidati i shkencave teknike *Lu Cang Keng*, të cilët në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit tekniko-shkencor në mes R.P.Sh. dhe R.P.K. qindruan për disa muaj pranë Universitetit shtetror të Tiranës. *Cic Zen U* dhe një ndihmë që madhe në Fakultetin e shkencave të natyrës për përvetësimin nga ana e punonjësve tonë të metodave kromotografike, ndërsa *Lu Cang Keng* i cili qindroi në katedrën e hidraulikës të Fakultetit të ingjenerisë ndihmoi mbi problemet teorike dhe eksperimentale të konstruksioneve hidroteknike, në ngritjen e bazës laboratorike dhe në përgatitjen e specialistave tonë në fushën e modelimeve me valçmas. Specialistat kinezë u dhuruan katedrave

përkatëse disa aparate shumë të vlefshme për punët shkencore.

Shënim i Redaksis. — *Shqiptari e ka për traditë mikpritjen, ka edhe nevojë me nxënë e m'u kulturue, kështu qi qofshin dyfish mirë t'ardhun dije-tarët e çdo kombi qi urdhnojnë në vend t'onë. Vetëm se, n'Universitet të Tiranës, po rrotullohen tepër shpesh profesorat e huej ndër dishiplina qu aty mësohen. Deri dje drejtimin kulturuer e kishin Rusët; sot Kinëzët. Po druem qi ata nxânsa, si të kryejnë kurset universitare me tërnim të shpeshë docentash, do të dalin në jetë e në shoqni me nji pështjellim bukur të theksuem njoftimesh e methudash.*



### Fillon vjeti shkollor 1962-63.

Tiranë, 16 shtatuer 1963

Sot në të gjithë vendin filloi viti i ri shkollor 1963-1964. Nxanësit, mbasi kaluan të gëzuar pushimet verore, u kthyen përsëri në shkollat e tyre plot shndet dhe energji të reja. Sivjet ata gjëjn shkollat të pajisura më mirë me mjete dhe orendi dhe me gjithëçka është e nevojshme për të vënë në jetë programet e reja të shkollës së riorganizuar. Që para orës 8 oborret e shkollave u mbushën me nxanësit. Në orën 7,45' nxanësit dhe arsimtarët ndëgjuan përshndetjen e ministrit të Arsimit dhe të Kulturës *Manush Myftiu* me rastin e vitit të ri shkollor.

Gjatë këtij viti shkollor do të ndjekin klasat e para të shkollave fillore 50.700 të ri, dhe në klasat e shtatëvjeçareve dhe tetëvjeçareve 30,780 të ri. Ndërsa në shkollat e mesme, të arsimit profesional, fillojn sivjet për herë të parë mbi 50,330 nxanës të ri. Ketë vit numri i nxanësve e të gjitha kategorive të shkollave do të arrijnë në afro 400.000 veta, ose afro 28.000 veta më

shumë se vitin e kaluar shkollor. Sivjet numrit të përgjithëshëm të shkollave do t'u shtohen edhe 21 shkolla fillore, 52 shkolla shtatë dhe tetëvjeçare, 10 shkolla 11-vjeçare, dhe nji teknikum. Nji punë e mirë është bërë për pajisjen e laboratorëve me mjete të reja, si pas kërkesave të shkollës së riorganizuar si dhe për kualifikimin dhe perfeksionimin e arsimtarve. Gjatë këtij viti shkollor nxanësit e klasave të para fillore janë pajisur me tekste të reja të përgatituna si mbas programeve të reja të shkollës së riorganizuar.



### Lajme Kosove

#### Teatri popullor krahinor në sezonën e ré.

Më 20 gusht në Teatrin popullor krahinor të Prishtinës filluen provat intenzive për premierat e sivjeme. Mbrenda kësaj sezone, në sqenën e teatrit do të çfaqen 15 pjesë teatrale n'interpretimin e dy ansambleve.

Skica e përgjithshme e repertoarit është aprovue nga ana e këshillit artistik dhe këshillit drejtues të Teatrit. Asht e udhës me theksue se as repertoari i sivjemë nuk është dhanë në diskutim publik, siç veprojnë teatrat tjera në Republikën e Serbisë dhe madje në tanë vendin tonë. Sikur repertoari të diskutohet publikisht, sikur vizitorët e rregullt të teatrit të kishin mundësi me dhanë mendimet e veta për çdo pjesë teatrale të sezonës së re, nuk ka dyshim se politika e repertoarit do të kishte qenë më stabile dhe më e studjueme. Megjithate, repertoari i sivjemë është mjaft interesant.

Drama shqiptare do të çfaqi sivjet, për herë të dytë, në fillim të sezonës, melodramën e Murteza Pezës «Nuk martohem me pare», në regjinë e

Muharrem Qenës. Qena, në marrëveshje me autorin, ka ba disa ndryshime dhe adaptime me vend. Kjo melodramë do të çfaqet kah mesi i muejit shtator. Ky ansambël është tue përgatitë njiherit edhe dramën Nesër mbas dite të Mire Shtefancit. Kjo pjesë do të luhet në sqenën e vogël. Regjija ia është besue Adburrahman Shalës.

Në planin e pjesëve teatrale gjindet sivjet edhe Tartufi i Molierit. Kjo komedi klasike, që tubon me qinda dashamirë teatrali gati në të gjitha sqenat këso-dore të botës, jemi të sigurt se do të ketë shum vizitorë. Në gjuhën shqipe do të çfaqen edhe disa pjesë tjera si, për shembull: I ndjeri i Branislav Nushiçit, me të cilën do të shenohet përvjetori i ditëlindjes së tij, mandej Profesori Mallok i Fridrih Volfit dhe nji pjesë teatraleë për fëmij. Këshilli artistik ka vendosë që ta vejë në repertoar edhe komedinë e re të Jusuf Kelmendit Do të ndëgjo-het.

(PERPARIMI - n. 8 - Gusht 1963 - Vjeti IX)

Antarët e zhyrisë së konkursit letrar për tregime të redaksis Rilindja Esad Mekuli, drejtor i revistës Jeta e Ré, Hilmi Agani, profesor i Fakultetit Filozofik të Prishtinës dhe Vehap Shita, redaktor i rubrikës së kulturës së Rilindjes, vendosën njizantë që me çmimin e dytë — 30.000 dinarë — të shpërblejnë tregimin Shtatë kumbonat e lirisë, autori i të cilit është Adem Gajtani. Ndërkaq, me çmimin e parë (50.000 dinarë) dhe me çmimet e treta (nga 20.000 dinarë) zhyrija nuk shpërbleu asnji tregim.

Ngasi mesi i 39 tregimeve, sa kanë mbërri në konkurs, zhyrija zgjodhi dhe i propozoi redaksisë së Rilindjes për botim 15 punime. Në komunikatën e zhyrisë, përveç tjerash, thuhet se përkundër numrit mjaft të madh të tregimeve, shumica e tyre nuk kanë qenë në nivelin e nevojshëm arti-

stik, prandej edhe është shpërblje vetëm nji tregim.

Në numrin e fundit për maj e qershuer revista letrare Stremljenja, që botohet në Prishtinë në gjuhën serbo-kroatishite, përveç materialit tjetër interesant sjell edhe disa përkthime prej letërsis sonë në gjuhën shqipe: kritikën e Hasan Mekulit me titull Karvani i bardhë — prozë e parë e Azem Shkrelit, tregimin e Hivzi Sulejmanit Miku im Xho dhe vjershat e Q. Ujkanit, A. Podrimjes dhe Rr. Dedajt.

(JETA E RE - n. 3 - maj-qershor - Vjeti XV)

Enti për Botimin e Teksteve të Republikës Socialiste të Serbis, redaksija e Prishtinës, çdo ditë e më tepër po bahet qendër e randësishme kulturore dhe arsimore e Krahinës sonë. Në botimin e tij, këto ditë, do të dalin prej shtypit veprat e zgjedhuna të Naim Frashërit, me parathanje të dr. Pjetro Janurës; Poezit dhe komedit e Çajupit, të përgatituna nga dr. Vojisllav Dançetoviçi; Vepra e Migjenit, me parathanje të Regjep Hoxhës; Hanko Halla dhe vjershat tjera t'Ali Asllanit, me parathanjen e Latif Berishës; përmbledhja e pjesëve më të bukura nga Iliada dhe Odiseja e Homerit dhe Eneida e Virgjilit etj. Ndërkaq, deri kha fundi i tetorit do të dalin shtypit edhe disa vepra të shkrimtarëve shqiptarë.

Hasan Mekuli, Enver Gjergjeku dhe Ramiz Kelmendi janë tue përgatit nji antologji të letërsis bashkëkohore shqipe në Jugosllavi. Në faqet e kësaj antologjije, e cila do t'u shërbej nxënësvë të shkollave të mesme dhe studentëve të shkollave të nalta dhe fakulteteve, do të botohen punimet më të bukura dhe më karakteristike të shkrimtarëve tanë t'afirmuem.

(JETA E RE - n. 4 - korrik-gusht - Vjeti XV)

## Përgëzime

Në muejt e fundit kemi pasë dy emnime me randësi në pjestarët e familjes së *Shêjzavet*. Bashkëpunatori i ynë e shkrimtari i ndritshëm *At Françjik Solano* (i njoftun me pseudonymin *Dushko Vetmo*) është emnue nga i Përnderueshmi Emzot Jan Mele, Ëpeshkëv i Lungro-s, si Theolog i Djoçezit; gjithashtu *prof. Zef Gradilone*, docent i lir e auktor veprash kritike letrare në shqipe, është emnue Lektor i rendomtë i Kathedrës së Shqipes n'Universitet të Romës.

### Zhdukja e Ali Klisurës.

Me 23 shtatuer vdiq në Romë Ali Klisura tue pikllue me zhdukjen e Tij të papritun familjen, t'afërmit, miq e dashamirë e të gjithë ata qi kanë për zëmër një rikambje së vërtetë të Shqipnis. Ishte bir i Xhelal beut. Me Të u shkim vija mashkullore e derës në zâ të Klisurajvet. I lindun me 1891, studjimet i ndoq në Stamboll në Liceun perandorak të Gallata Serajit. U doktorue në Romë. Ç'në riní u hodh në lëvizjet kombtare, tue spikatë për ndienja të flakta atdhetare e për idëna të gjána politike. Përfaqësoi në Parlament të Shqipnis, qyshë prej legjislatures mâ të parë, krahinën e Gjinokastrës. Ndërhÿmjet e Tija me gojtari tërhjekse kanë me mbetë të pashlyeshme ndër anale të Parlamentit shqiptar. Luftoi me pendë e me fjalë, dhe kur e lypi nevoja edhe me pushkë, për idën e një

Shqipnije së përparueme e moderne, tue u dalë zot, reformave shoqnore mâ përtrise. Për shkak të mendimeve të reja, qi Ai mâ i pari shfaqti e shpalli në jetën politike shqiptare, ndeshi shpesh në pakupitime e në vishtirsína dhe pësoi mërgime e vuetjtje. Me Të po zhduket një frymzues i madh i mërgatës nacionaliste shqiptare, në një kohë kur mâ tepër ndiehet nevoja e veprimtarís së Tij dinamike. E përkohëshmjja «*Shêjzat*» zojës Advije Klisura-Vrioni dhe së Bijës zojushës Hána, u paraqet ngushullime, tue marrë pjesë me zëmër në zín e madhe të Tyne.

### Kolonel Quku ndrroi jetë.

Në New York, ku tallazet e rrebeta të mbasluftës e kishin mërgue, vdiq midis verës qi shkoi Kolonel Faik Quku, një ndër ofcjera mâ të pregatitun t'ushtrís kombtare. Me 20 të korrikut i u bânë salikimet në pranín e një shumice Shqiptarësh qi e përsollën me nderime e përmallim në banesë të fundit. I ndiem i ishte në letërshkëmbim të shpeshtë me Redaksin e së përkohëshmes s'onë, veprimtarín kulturore të së cilës shum e çmonte tue e nxitë dhe tue e përkrahë vazhdimisht. Rrethi i «*Shêjzave*», tue u përulë në shëjponije para Hijes së këtij kryeushtari shqiptar, i paraqet familjes së Tij përdhimbtime të sinqerta.

Il 12 ottobre 1963 si è spento improvvisamente il *Comm. Antonio Urbinati*, proprietario della Tipografia dove da anni si stampa la nostra Rivista. Rapporti di calda amicizia esistevano fra i redattori di *Shêjzat* e l'Estinto, che seguiva con simpatia l'opera loro intesa a diffondere la conoscenza dei valori spirituali albanesi. Alla Famiglia la Direzione e la Redazione di *Shêjzat* inviano le più sentite condoglianze.

Il 17 ottobre 1963 è deceduto il prof. *Silvio Giuseppe Mercati*, insigne bizantinologo, professore emerito della Università di Roma. Era amico degli studi albanesi. Al Prof. Giuseppe Schirò, suo alunno affezionato che gli è succeduto nella Cattedra, *Shêjzat* presentano vive condoglianze per la scomparsa del suo grande Maestro.

## Botime të reja

« *Zgjimi* » (il Risveglio - Rivista internazionale di informazione e di cultura - Direttore responsabile: *Albino Greco*. Direzione: Via Piano dei Rossi, 3 - S. Benedetto Ullano (Cosenza).

Me gëzim e përzëmërsi përshtëndesim botimin e kësaj së përkohëshme italo-shqiptare tue i urue jetë të gjatë dhe punë të mbarë. Numri i parë (Máj-Qershuer 1963) ka në të hým riprodhimin e një pikturë t'artistit të njohun shqiptar Lin Delija dhe një përmbajtje, ndër faqe të mbrendëshme, mjaft t'interesueshme. Copat shqip të Bernard Bilottës, — shkrimtar nga Frasnita qi punoi shumë gjuhën dhe la një tubë veprash njána mâ e tërhjekëshme se tjetra, disa të botueme disa të pabotueme — kanë randësi gjuhsore dhe letrare. Një artikull mbi Jul Varibobbën, një syzim i gjânë e plot

njohuni të landës mbi konferencën e mbajtur nga prof. Alois Schmaus në Romë mbi epikën popullore shqiptare e kronika e lajme e prova tjera kulturore apin me shpresue se kjo e përkohëshme tekembramja do të plotsojë shprazëtin qi ndiehej për sa i përket kumtimit mbi jetën e Arbreshvet t'Italis.

Janë 80 bashkina nga Villa Badessa (afër Peskarës) deri në Kuntisë të Sicilis qi flasin ende shqip ose qi mbajnë doke shqiptare. Ngjarjet e kësaj bote së vogël arbreshe humbin, nga shkaku i shpërndamjes së bashkive ku ajo zhvillohet, midis botës së madhe italjane. Një botim muejue qi të ndiqte ngjarjet e ndryshme të tyne besojmë se do të kënaqte Arbreshët dhe Shqiptarët d.m.th. mbarë gjinden qi flet shqip dhe ruen kultin e traditave arbrenore.

Jemi të sigurtë se dr. Albin Greko, të cilit i a njofim vullnetin e fortë dhe zotsin, do t'i shërbejë me këtë botim njoftjes së ndërmjetvetëshme të « gjakut t'onë të shprishun ».

GIUSEPPE FERRARI: *Giulio Varibola e la sua opera poetica albanese*, Casa Editrice Cressati - Bari, 1963, pagine 79, Lire 1.000.

Poeti Jul Variboba nga Mbuzati (S. Giorgio Albanese) me të cilin mund të thuhet se fillon ndër në aradhja e vjerrshatarvet me randësi vërtë artistike, shfaqë me jetën e vet ende mbulue me ertësi dhe me vepra plot gjenjalitet e hov poetik, probleme të ndryshme gjuhsore, historike e letrare. Zef Ferrari përpiqet me përshkrue s'pari tematikën e çashtëve qi Variboba paraqet, mandej me dhanë mendimin e vet mbi disa prej atyne çashtëve. Cakton datat e lindjes dhe të vdekjes qi deri tash nuk ishin të njoftuna me saktësi. Analizon gjuhën (ligjirimin e veçantë) të Poetit mbi disa copa në prozë e në vjerrshë nxjerrë nga veprat e poetit. Vëllimthi i Ferrari-t, edhe

pse nuk i ep zhvillim përfundues pyetjevet që zgjon leximi i poemthit «Gjella e Shën Mëris Virgjërë», që është kryevepra e Varibobës, prap se prap sjell një kontribut të shënueshëm në studim të vjerrshatariit arbresh. Do të ishte mirë që poemthi në fjalë të botohej me një transliterim në alfabet të Monastirit.

EMANUELE GIORDANO: *Fjalor i Arbëreshvet t'Italisë* (Dizionario degli Albanesi d'Italia) - Edizioni Paoline - Bari, Luglio 1963, pp. 660, L. 6.000.

Që një vepër madhështore e cila vjen e rradhitet në numër të veprave të vërteta të dobishme në lëmin e albanologjisë. Një fjalor arbresh mungonte. Me zell të admirueshëm, me mundim të pasqorë, me kërkesa të parreshtuna e me një punë vjetsh e vjetsh, At Manoil Gjordanò, nip i të shquemit letrar Bernardino Bilotta, tekembramja ia dhuroi studjuesave të shqipësisë mjetin që mungonte për të depërtuar pa zorime në botën e letrësisë arbreshe. Tashti aukto-

rët e mëdhej italo-shqiptar Variboba. De Rada, Dara, Santori, Serembe, Argondizza, Schirò etj. nuk do të mbesin të pakuptuëm. Çelsi t'është.

Fjalori është shtypë me kujdes të rrallë. Ka një parathënie ndriçuese mbi probleme gjuhësore arbreshe, ka shënime të plota bio-bibliografike, emnat e të gjitha katundeve arbreshe, ka në fund edhe një rradhje emnash gjeografikë bashkë me një tjetër emnash vetjesh. Në format të madh përmban 600 faqe.

Në numrin e ardhëshëm të *Shëzave* redaktori i ynë kompetent për gjuhësi do t'ia analizojë imtisht këtë vepër që pasuron jashtzakonisht visarin albanologjik. Vepër mund të kërkohej pranë auktorit: Sac. Emanuele Giordano - Ejanina (Cosenza) - Italia. Kush-ton \$ 10 (dhjetë).

Nuk na mbetet veç me i porositë nxehtësisht lexuesat t'onë dhe dashamirët e gjuhës shqipe t'ia blejnë e t'ia vëdojnë Fjalorin e Giordano-s në një vend nderi në libretoren e tyre.

### SI FALEN DO POPUJ

Harapët e bregut t' Afrikës të shtrydhin 3 herë gishtin e mjesëm në shëj të falunit; Japonasi hjekë një pashmangë, nersá Lapónasi rrasë me forcë hunden e vet kundra s'ates. N'Indostan i falen kujej tuj e ngrehë për mjekrret, nersá banorët e ishujve Filipine marrin doren t'andë e me të t'i ferkojnë faqet. Shqyptarët vënë doren në zëmer, o çojnë doren tu kryet, asë napin doren o edhe rroken me shoqishojnë.

Kjo á mimika, si me thanë, e të falunit.

Me fjalë që si pershndeten disá popuj:

*Frangëzi* — Si po pruhesh? (*Comment vous portez-vous?*)

*Inglizi e Amerikani* — Si po bân ti?

*Italjani* — Si po rrin ti?

*Aleman* — Si po gjindesh?

*Olandezi* — Si po shkon kjo punë?

*Svedezi* — A po mundesh?

*Kinezi* — Si po e kë zgrofin? A e kë hanger orizin t'and?

*Polonasi* — Si po e kë vedin?

*Rusi* — Si po jeton ti?

*Persiani* — Mujtë hija e jote mos me t'ardhë kurr mangut!

*Shqypitari* — A jé burrë, si jé, qysh jé, etj.

(Nxierrë nga KALENDARI i Vjetës 1921, Vepër Pijore N. 27, faqe 25).

## LA LIRICA ALBANESE

(da: « IL FALSO E IL VERO VERDE »  
di SALVATORE QUASIMODO)

Un' « **Antologia della lirica albanese** », con note e introduzione del poeta **Ernesto Koliqi**, è stata pubblicata dall'Editore Vanni Scheiwiller di Milano. I primi documenti scritti, nei quali si ferma l'antica tradizione orale della poesia albanese, sono del 1500. La voce popolare, rimandata dall'eco delle generazioni nel canto legato ai ritmi e alle figurazioni delle danze intrecciate in geometrie colorate, è chiusa per la prima volta nelle sottili pagine dei volumi all'epoca del nostro Rinascimento. Il « dolce stile » di Albania ha schermi ideali nelle figure simboliche degli eroi. Le loro imprese, però, sono contaminate da un'epica di derivazione greca — purificata, rispetto a quella di Omero da una concezione dell'orgoglio meno politica e più religiosa — e da un idealismo di natura medievale dove il cavaliere errante è immagine ingenua di un racconto locale. L'amore, oltre i sentimenti della morale tradizionale, è intuito come sensualità naturale, contadina, o come piacere dall'ondulata sequenza di preziosi tesori derivati dalla civiltà orientale in cui la lingua e il costume velano il senso. Le gonfie tende stellate di ori dell'Oriente non hanno coperto inutilmente i secoli della storia di Albania: i motivi arabi, turchi o persiani arrivano da quelle regioni non lontane e dalla dominazione presente nei versi dei poeti che hanno sempre affermato il loro rifiuto alla reggia bizantina. Certamente, in mezzo alle immagini di fissità e di decorazione del cromatismo di Levante, la volontà poetica rimane precisa nella sua natura realistica e primitiva, mediterranea e rustica. L'esilio, sulle rive della Calabria o della Sicilia, fa incominciare un canto per i lirici albanesi dell'Ottocento che mescola alla malinconia della lontananza

la disperazione di un ritorno. Il misticismo romantico ed eroico di De Rada e Frashëri (un « Risorgimento » che è una redenzione universale dell'umanità e comprenda il riscatto della patria dalla schiavitù religiosa e, quindi, politica) e il naturalismo di Giorgio Fishta. « Dalla mia dolce terra - mi bandì lo straniero: - e la lasciai mentre nel ciel tinniva - la campana alla cui diletta voce - crebbi e mai più nella città natale, - ove passai la vita come in sogno, - mai più non rientrerò ». Qui il De Rada non deve avere lontane le cadenze di certe ballate romantiche. Altrove (« Solo che s'incontrino - i nostri occhi e poi il mondo - si consumi in cenere ») l'amore risolve in un compiacimento di apocalissi il pensiero dominante della insurrezione. Le lotte per l'indipendenza in Albania hanno, come in tutte le occasioni simili, levati cori di esaltazione per la libertà, di patriottismo più o meno sinceri. La retorica è spesso presente in quegli inni per la città riconquistata. Schirò, Çajupi e Mjedja riescono a « sentire » ancora la voce della tradizione. Ma anche in Albania le ansie futuriste e le metamorfosi della scuola europea dei movimenti moderni creano la mitologia dell'imitazione internazionale. Le correnti scivolano in discesa verso numerose direzioni: si oscurano e si fermano nell'acqua dell'impero di proiezione fascista. I poeti contemporanei albanesi, dopo le incertezze dei primi anni di imitazione marxista, conoscono un presente in cui il tempo è vita, non senza memoria, però, dei sogni complicati di finestre bizantine o leggeri e dolci delle nenie delle rapsodie dei pastori, il popolo di montagna della più antica e autentica Albania.

(LE ORE - Nr. 5 - Nuova Serie - 6 sett. 1963).

# Vargu i botimeve të marruna

- GIOVANNI MELE:** Lettera Pastorale Anno 1963: La Fede - Castrovillari Prem. Stabilim. Tipogr. Eduardo Patitucci, 1963, pp. 16.
- EMANUELE GIORDANO:** Fjalor i Arbëreshvet t'Italisë (Dizionario degli Albanesi d'Italia) Albanese-Italiano — Edizioni Paoline - Bari, Luglio 1963, pp. 600, 10 dollari U.S.A.
- LUIGI BASSANO:** Costumi et i modi particolari della vita de' Turchi - Ristampa fotomeccanica dell'edizione originale (Roma, 1545), corredata da una introduzione, note bio-bibliografiche ed un indice analitico a cura di FRANZ BABINGER - Casa Editrice Max Hueber, Monaco di Baviera, 1963, pp. XI-140, s.i.p.
- Dr. BAYMIRZA HAYIT:** Some Problems of Modern Turkistan History - East European Research Institute - Düsseldorf 1963, pp. 60, s.i.p.
- GIUSEPPE FERRARI:** Giulio Variboba e la sua opera poetica albanese - Casa Editrice Cressati - Bari, 1963, pp. 79, Lire 1.000.
- ARTURO CAPASSO:** Charasciò! - Viaggio in Russia - Vito Bianco Editore, Roma, 1963, pp. 144, Lire 1.000.
- Balkan Studies** - A biannual Publication of the Institute for Balkan Studies - Volume 4 - Number One - Thessalonike, 1963, pp. 224.
- Calabria Nobilissima** - Periodico di Arte, Storia e Letteratura - Anno XVI - n. 43 - 1962 - un numero L. 800.
- ANTON ÇETTA:** Tregime Popullore - I - Drenicë - Bleni i Parë - Rilindja, Sipërmarrje Gazetare-Botuese, Prishtinë-1963, faqe 332.
- L'Unità Mediterranea** - Annali della Accademia del Mediterraneo - Atti del VI Congresso Internazionale a cura di ROSARIO DURANTE - G. Denaro-Editore, Palermo 1962, pp. 424, Lit. 2.500.
- Dr. MARK KRASNIQI:** La communauté familiale albanaise dans la région de Kosovo et Metohija - Extrait - Glasnik Muzeja Kosova i Metohije, Knj. IV-V (1959-1960), str. 137-171.
- Dr. MARK KRASNIQI:** O « Besi » prilog proučavanju običajnog prava kod šiptara - Extrait - Zagreb 1962.
- Dr. MARK KRASNIQI:** Les « kula » (maisons-forteresses) en Metohija - Extrait du « Bulletin de l'Institut Ethnographique de l'Académie serbe des Sciences VII (1958) », Beograd 1958.
- PETRE CIUREANU:** Dora d'Istria in « Revue des Études roumaines », II, 1954, p. 169-192 e III-IV, 1957, p. 82-110.
- PETRE CIUREANU:** Gli articoli di Niccolò Tommaseo nell'Encyclopédie des Gens du monde - Genova-Sampierdarena, Scuola Tipografica Don Bosco, 1952, pp. 30, s.i.p.
- PETRE CIUREANU:** Lettere inedite di Michel Bréal - Estratto dal « Bollettino dell'Istituto di Lingue Estere » V. 5, Genova-1957, pp. 28.
- PETRE CIUREANU:** Appunti su due scritti di Pietro Verri - Estratto dal « Bollettino dell'Istituto di Lingue Estere », VI, Genova-1961, pp. 8.
- PETRE CIUREANU:** Lettere inedite di filologi romeni a Gaston Paris - Estratto dal « Bollettino dell'Istituto di Lingue Estere », VI, Genova-1961, pp. 34.
- PETRE CIUREANU:** Hortense Allart e Anna Woodcock (con lettere inedite) - Genova - Tolozzi & C. - 1961, pp. 60, s.i.p.

Të gjitha botimet qi arrijnë në Redaksi shenohen në këtë varg. Ato qi kanë nji randësi të veçantë, do të shqyrtohen ndër rubrika përkatsë.

## PAJTIMET E PERVJECME

Për Itali  
N'Europë  
Për USA, Kanada e Australi

Lit. 3.200  
\$ 8  
\$ 12

## ABBONAMENTO ANNUALE

Italia  
Europa  
USA, Canada, Australia

Lit. 3.200  
\$ 8  
\$ 12

Registrato il 26-7-1957 al n. 5898 del Registro del Tribunale di Roma

Arti Grafiche Comm. A. Urbinati - Via De' Bresciani, 38 - Roma - Tel. 65.35.47

Ka dalë në këto dit:

**E' uscito:**

# Fjalor i Arbëreshvet t'Italisë

(DIZIONARIO DEGLI ALBANESI D'ITALIA)

Porositnje ke: Sac. EMANUELE GIORDANO

**Richieste:** Ejanina (Cosenza)

Kushton: Dollarë U.S.A. 10

**Prezzo:**

## **Shqiptarë!**

Kjo vepër 600 faqesh nuk duhet të mungojë në libërtoren e Juej. Porositnje sa më parë.

Numer dyfish Lit. 600